

UDHËZIM
Nr. 8, datë 14.5.2026

**PËR PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR MASAT
MBËSHTETËSE, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të shkronjës “c”, pika 2, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”; dhe të VKM-së nr. 205, datë 30.3.2026, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2026”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

I. PËRDORIMI I FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2026, zëri “Transferte në buxhetet familjare” (llogaria ekonomike 606), të përdoret për masat mbështetëse, si më poshtë vijon:

Nr. i masës	Emërtimi i masës mbështetëse
1	Pagesa në vlerën deri në 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë/krerë, për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë dhe/ose mëshqerra. Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB)”.
2	Pagesa në vlerën deri në 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) krerë dele dhe/ose dhi. Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.
3	Mbarështimi i bletarisë në vlerën deri në 2 000 (dy mijë) lekë për zgjua, për fermer/aplikant me jo më pak se 25 (njëzet e pesë) zgjoje. Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.
4	Pagesa për dosa dhe/ose paradosa të matrikulluara në vlerën deri në 7 000 (shtatë mijë) lekë/krerë dosë/paradosë, për fermer/aplikant me jo më pak se 5 (pesë) krerë dosa dhe/ose paradosa. Për pjesën mbi 100 (njëqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.
5	Pagesa për kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, specat, tranguj), në serra dhe/ose luleshtrydheve në tunele plastike. Masa e përfitimit është 70 (shtatëdhjetë) % e vlerës totale të faturave tatimore, për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme, por jo më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë për dynymë në rastin e dy mbjelljeve në vit. Për fermerët individualë, që aplikojnë për mbështetje për kontrollin biologjik, sipërfaqja minimale e kultivuar është 1 (një) dynym, ndërsa për aplikantët me status “SHBB” sipërfaqja minimale është 1 (një) ha, për secilën nga mbjelljet.
6	Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar.

7	Implementimi dhe certifikimi global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore: i. por jo më shumë se 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për certifikim individual; ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup me minimum 10 (dhjetë) fermerë të përfshirë; iii. por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup me minimum 20 (njëzet) fermerë të përfshirë.
8	Pagesa, në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për ha, sipërfaqe të mbjellë me kultura bujqësore. Sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 3 (tre) ha. Për sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.
9	Mbështetje për aktivitetin ripopullim peshkimi për ujërat e brendshme për blerje rasate peshku. Masa e përfitimit të jetë në 50 (pesëdhjetë)% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë për subjekt.
10	Për fermerë të rinj, për investime në ferma bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 70 (shtatëdhjetë) %, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.
11	Për ndërtimin/rikonstruksionin e staneve dhe/ose pajisjeve për përmirësimin e kushteve. Masa e përfitimit të jetë në 70 (shtatëdhjetë) %, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë për subjekt.
12	Për pajisje, makineri dhe mjete bujqësore për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në ferma bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 50 (pesëdhjetë) %, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt dhe jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.

II. SHKURTIME/PËRKUFIZIME

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMTP	Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
AREB	Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
BE	Bashkimi Evropian
DAMT	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark
DAP	Drejtoria e Autorizimit të Pagesave në AZHBR
DEP	Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave në AZHBR
DK	Drejtoria e Kontrollit në AZHBR
DPAP	Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve në AZHBR
DVASHT	Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
DRVMB	Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Ministria e Financave
NIPT	Numri i Identifikimit i Personit të Tatueshëm
NUIS	Numri Unik i Identifikimit të Subjektit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RUDA	Sistemi i Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve
SHBB	Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor
SMI	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Masën mbështetëse nr. 8, “Pagesa, për sipërfaqe të mbjellë me kultura bujqësore”
SPAP	Spektori i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve në AZHBR

“Kushtëzimi” u referohet “Kërkesave ligjore për menaxhim (SMR)” dhe “Kushteve të mira bujqësore dhe mjedisore të tokës (GAEC)”, për t’u përmbushur nga fermerët që përfitojnë pagesa për ha ose për krerë, sipas përcaktimeve në legjislacionin e BE-së dhe të bazuara (përfshira) në legjislacionin shqiptar.

“Sezoni i mbjelljes” lidhet me kohën e mbjelljes së kulturave bujqësore. Sezoni i parë përfshin mbjelljet e kulturave bujqësore në periudhën 1 tetor 2025 deri më 31 maj 2026. Sezoni i dytë përfshin mbjelljet e kulturave bujqësore në periudhën 1 qershor 2026 deri më 30 shtator 2026.

III. KRITERE TË PËRGJITHSHME TË PËRFITIMIT

1. Përfitues sipas masave mbështetëse mund të jenë fermerët individualë, personat fizikë, personat juridik dhe SHBB-të.

2. Aplikanti mund të aplikojë dhe përfitojë vetëm në një ose në të gjitha masat mbështetëse, kur përmbush kriteret përkatëse për secilën masë.

3. Fermerët individualë të jenë të pajisur me NIPT-in e fermerit me status aktiv.

4. SHBB-të, personat fizikë dhe juridikë të jenë të pajisur me NIPT/NUIS me status aktiv, sipas fushës së veprimtarisë që përfshin aktivitetin për të cilin aplikojnë.

5. Për masat mbështetëse nr. 1–8, përfituesi me status fermer individual të këtë bërë “shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore”.

6. Faturat për masat mbështetëse direkte, në përputhje me kriteret përkatëse, duhet të jenë të lëshuara gjatë periudhës 2025–2026.

7. Financimi i shumës së përfituar bëhet në bankat e nivelit të dytë, në llogarinë bankare të deklaruar nga përfituesi në formularin e aplikimit.

8. Përfituesi (ortakët, përfaqësuesi ligjor, anëtarët e SHBB-së) nuk duhet të jenë debitorë ndaj AZHBR-së dhe MBZHR-së.

9. Aplikanti angazhohet të përmbushë kushtëzimet (SMR dhe GAEC) të përfitimit të pagesave, sipas masave mbështetëse dhe të përshkruar në anekset përkatës. Përmbushja e angazhimeve kontrollohet në terren nga specialisti/inspektori i ngarkuar. Mospërmbushja e angazhimeve, për vitin 2026, nuk përbën kriter skualifikues dhe nuk shoqërohet me zvogëlim të pagesave për masën përkatëse. Megjithatë, sipas rastit, specialisti/inspektori paralajmëron aplikantin për zvogëlim potencial të pagesave në të ardhmen dhe aplikim sanksionesh, sipas kuadrit ligjor kombëtar në fuqi.

10. Për **masat mbështetëse të investimeve nr. 10, nr. 11 dhe nr. 12**, punimet e ndërtimit, pajisjet, makineritë dhe faturat/aktet e zhdoganimit duhet të jenë pas datës së lidhjes së kontratës.

11. Të gjitha mallrat, makineritë dhe pajisjet duhet të jenë të reja dhe të papërdorura.

12. Financimi për masat e investimeve jepet deri në vlerën e tregut të përlllogaritur nga AZHBR-ja, pa përfshirë TVSH-në. Vlera e tregut do të përlllogaritet:

- nga manuali i çmimeve në ndërtim nga *e-Albania* për punimet e ndërtimit;
- mbi bazën e zërave të mallrave, makinerive/pajisjeve dhe punimeve ndërtimore (AN) të parashikuara në aplikim, duke marrë si referencë çmimet më të ulëta për njësi të evidentuara në ofertat e aplikimeve.

13. Përfituesi nga masat e investimeve me statusin fermer individual të këtë shlyer sigurimet shoqërore.

14. Aplikantët për masat e investimeve do të përjashtohen nga përfitimi i fondeve publike nëse janë dënuar, me vendim gjyqësor të formës së prerë për, pjesëmarrje në një organizatë kriminale, korrupsion aktiv ose pasiv, mashtrim, pastrim të parave, falsifikim dokumentesh, shpërdorim detyre, përvetësim fondesh publike ose private, evazion fiskal, pjesëmarrje në një organizatë terroriste ose kryerje të veprave me qëllime terroriste, fshehje të ardhurash ose

deklarim i rremë financiar, falimentim i rremë (falimentim mashtrues), kontrabandë ose tregti e paligjshme dhe çdo veprimtari tjetër të paligjshme që dëmton interesat ekonomikë ose financiarë publikë.

15. Për ofertat në valutë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e hapjes së aplikimit.

16. I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose, në rast se është në gjuhë të huaj, të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

17. Për masat e investimeve kur dokumentacioni i kërkuar, dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose pasaportës biometrike, formularit të regjistrimit në QKB të ofertuesve, certifikatës/vërtetimit të pronësisë, AMTP-së, hartës treguese) të jetë i noterizuar.

18. Në rastet kur aplikanti aplikon në dy masa investimesh, financimi jepet vetëm për ato investime që janë specifike, të veçanta dhe të dallueshme për secilën masë. Nuk pranohen për financim investime, makineri apo pajisje që janë të njëjta ose që realizojnë të njëjtin funksion, objekt apo qëllim investimi në të dyja masat.

19. Aplikantët që kanë përfutur nga masat e investimeve për vitin 2024 dhe/ose për vitin 2025, nuk mund të aplikojnë dhe të përfitojnë për të njëjtat makineri apo pajisje.

20. Të gjithë aplikantët para përfitimit duhet të plotësojnë/përditësojnë regjistrin e fermës.

Kriteret e përcaktuara në pikat më sipër për pagesat direkte, Masat 1–9, vërtetohen nga ndërveprimi me regjistra të tjerë elektronikë në formën e aplikimit dhe në sistemin elektronik ku trajtohen aplikimet.

IV. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR APLIKIMIN

a) Informacioni i nevojshëm për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe procedimit deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë agropikave, pranë Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, zyrave qendrore të AZHBR-së si dhe në faqen e saj të internetit: www.azhbr.gov.al.

b) Aplikimet për të gjitha masat mbështetëse do të bëhen nga data **25 maj 2026 deri më 26 qershor 2026**. Nëse fondi i planifikuar nuk ezaurohet nga aplikimet e bëra ose aplikantë që plotësojnë kriteret e përfitimit nuk kanë arritur të kryejnë aplikimin brenda afatit të mësipërm, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mund të vendosë për shtyrjen e afatit të aplikimeve apo hapjen e një thirrje të re.

c) Aplikimet për masat mbështetëse nr. 1 – nr. 9 do të bëhen *online*.

ç) Aplikimi *online* është i mundshëm përgjatë 24 orëve, nga ora 08:00 e datës së hapjes deri në orën 24:00, të datës së përfundimit të periudhës së aplikimit.

d) Aplikimi *online* do të bëhet në portalin *e-Albania*. Aplikantët kur e kanë të nevojshme asistohen paraprakisht nëpërmjet numrit jeshil 08008383, nga specialistët e agropikave dhe të agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor dhe bashkive.

dh) Lista e agropikave dhe zyrave të bujqësisë, ku fermerët asistohen për të kryer aplikimin *online*, gjendet në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

e) Në rastet kur flukset e aplikimeve janë të larta dhe nuk përballohen nga zyrat e aplikimit të përcaktuara në aneksin 1, në bashkëpunim me bashkitë përkatëse mund të hapen edhe zyra të tjera aplikimi, duke angazhuar edhe specialistët e bujqësisë pranë tyre.

ë) Procedura e aplikimit nga portali *e-Albania* përfundon me dërgimin me sukses të formatit elektronik të formularit të aplikimit. Formulari i plotësuar i aplikimit printohet dhe një kopje e tij i jepet aplikantit.

f) Renditja e aplikimeve bëhet automatikisht nga sistemi në rang kombëtar dhe për çdo masë mbështetëse.

g) Aplikimet për masat mbështetëse të investimeve me nr. 10–nr. 12 do të bëhen *me dosje fizike* në zyrat qendrore të AZHBR-së brenda orarit zyrtar, ose me postë në adresën:

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), rruga “Muhamet Gjollësia”, nr. 56, Tiranë.

gj) Për qëllime identifikimi, aplikanti, sipas statusit përkatës (fermer individual/person fizik/juridik, SHBB), ose përfaqësuesi i tij me prokurë ose autorizim, duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR-së me letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike.

V. DOKUMENTACIONI QË GJENEROHET NGA REGJISTRAT ELEKTRONIKË DHE MODULI I PUNONJËSVE QEVERTARË:

1. Formulari i aplikimit për masën mbështetëse përkatëse;
2. Të dhënat e kartës së identitetit të aplikantit;
3. Dokumenti që vërteton statusin e aplikantit (fermer, person fizik/juridik, SHBB);
4. Konfirmimi që aplikanti (ortakët, përfaqësuesi ligjor, anëtarët e SHBB-së) nuk janë debitorë ndaj AZHBR-së dhe MBZHR-së;
5. Dokumenti për “shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore”;
6. Dokumenti që konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore;
7. Leje apo licenca për masat përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;
8. Regjistri Elektronik i Blegtorisë dhe Bletarisë (RUDA);
9. Dokumentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Aplikantët, për masat mbështetëse nr. 1–nr. 9 për të cilët ndonjë dokument nuk arrihet të gjenerohet nga regjistrat zyrtarë, apo nuk plotësojnë kriteret e përfitueshmërisë, informohen nëpërmjet listës së aplikantëve përfitues.

Dorëzimi i dokumentacionit për masat mbështetëse nr. 1–nr. 9, bëhet në agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së fizikisht, me postë ose nëpërmjet sistemit *e-Albania*.

Afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit për masat mbështetëse nr. 1–nr. 7 dhe nr. 9 është 20 ditë kalendarike pas publikimit së listës së aplikantëve përfitues, në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al. Për masën nr. 8, afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit është 10 ditë kalendarike.

Për masat e investimeve me nr. 10–nr. 12, nëse ndonjë dokument nuk arrihet të gjenerohet nga regjistrat zyrtarë, aplikantët informohen zyrtarisht nga AZHBR-ja me shkresë për plotësim dokumentacioni, i cili dorëzohet nga aplikanti në AZHBR jo më vonë se 20 ditë kalendarike nga afati i marrjes së njoftimit.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me propozim të AZHBR-së mund të miratojë shtyrjen e afatit të dorëzimit të dokumentacionit nga aplikantët.

VI. KRITERET SPECIFIKE DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR MASAT MBËSHTETËSE NR. 1, NR. 2, NR. 3, NR. 4, NR. 5, NR. 6, NR. 7 DHE NR. 9

Masa 1. Pagesa në vlerën deri në 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë/krerë, për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë dhe/ose mëshqerra.

Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB)”.

i. Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik:

- a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;
- b) Aplikanti duhet të ketë jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë dhe/ose mëshqerra, të matrikulluara. Në ditën e aplikimit moshë e lopëve duhet të jetë jo më pak se 20 muaj, ndërsa moshë e mëshqerrave jo më pak se nga 10 muaj.

c) Kafshët, sipas kategorive lopë dhe mëshqerra duhet të jenë të regjistruara në Sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve – RUDA;

ç) Përfituesi nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së dhe AZHBR-së.

ii. Angazhimi për përmbushjen e kushtëzimeve

Angazhimet për përmbushjen e kushtëzimeve për masën nr. 1, të jenë në përputhje me aneksin 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

iii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e përfituesve

a) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Aplikanti duhet të dorëzojë këtë dokument, pranë agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së, brenda 20 ditë kalendarike pas publikimit të listës së përfituesve ose edhe në momentin e verifikimit.

Masa 2. Pagesa në vlerën deri në 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) krerë dele dhe/ose dhi.

Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.

i. Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik:

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

b) Aplikanti duhet të ketë në tufën bazë jo më pak se 50 (pesëdhjetë) krerë dele dhe/ose dhi, të matrikulluara. Për efekt përfitimi të pagesës, kafshë riprodhuese konsiderohen kafshët gjendje në tufë, me moshë jo më pak se 6 muaj, në momentin e aplikimit. Numri i meshkujve riprodhues që mbështeten të jetë jo më shumë se 8 (tetë) krerë për çdo 100 (njëqind) krerë kafshë femra;

c) Kafshët e tufës bazë duhet të jenë të regjistruara në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve – RUDA;

ç) Përfituesi nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR dhe AZHBR.

ii. Angazhimi për përmbushjen e kushtëzimeve

Angazhimet për përmbushjen e kushtëzimeve për masën nr. 2, të jenë në përputhje me aneksin 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

iii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e përfituesve

a) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Aplikanti duhet të dorëzojë këtë dokument, pranë agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së, brenda 20 ditë kalendarike pas publikimit të listës së përfituesve ose edhe në momentin e verifikimit.

Masa 3. Mbarështimi i bletarisë në vlerën deri në 2 000 (dy mijë) lekë për zgjua, për fermer/aplikant me jo më pak se 25 (njëzet e pesë) zgjoje.

Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.

i. Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik:

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

b) Aplikanti të ketë jo më pak se 25 (njëzet e pesë) zgjoje;

c) Aplikanti si fermer individual në momentin e verifikimit të ketë jo më shumë se 1 vendndodhje për 25–50 zgjoje të bletëve, jo më shumë se 2 vendndodhje për 100 zgjoje dhe jo më shumë se 3 vendndodhje për 150 zgjoje;

ç) Zgjojet e bletëve të jenë të regjistruara në regjistrin elektronik të blegtorisë dhe bletarisë RUDA;

d) Përfituesi nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së dhe AZHBR-së.

ii. Angazhimi për përmbushjen e kushtëzimeve

Angazhimet për përmbushjen e kushtëzimeve për masën nr. 3, të jenë në përputhje me aneksin 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

iii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e përfituesve

a) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Aplikanti duhet të dorëzojë këtë dokument, pranë agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së, brenda 20 ditë kalendarike pas publikimit të listës së përfituesve ose edhe në momentin e verifikimit.

Masa 4. Pagesa për dosa dhe/ose paradosa të matrikulluara në vlerën deri në 7 000 (shtatë mijë) lekë/krerë dosë/paradosë, për fermer/aplikant me jo më pak se 5 (pesë) krerë dosa dhe/ose paradosa. Për pjesën mbi 100 (njëqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.

i. Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik:

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

b) Aplikanti duhet të ketë jo më pak se 5 (pesë) krerë dosa dhe/ose paradosa, të matrikulluara. Në ditën e aplikimit mosha e dosave duhet të jetë jo më pak se 8 muaj, ndërsa mosha e paradosave jo më pak se 6 muaj;

c) Kafshët, sipas kategorive dosa dhe paradosa duhet të jenë të regjistruara në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve – RUDA;

ç) Përfituesi nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së dhe AZHBR-së.

ii. Angazhimi për përmbushjen e kushtëzimeve

Angazhimet për përmbushjen e kushtëzimeve për masën nr. 4, të jenë në përputhje me aneksin 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

iii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në Listën e përfituesve

a) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Aplikanti duhet të dorëzojë këtë dokument, pranë agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së, brenda 20 ditë kalendarike pas publikimit të listës së përfituesve ose edhe në momentin e verifikimit.

Masa 5. Pagesa për kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, specat, tranguj), në serra dhe/ose luleshtrydheve në tunele plastike.

Masa e përfitimit është 70 (shtatëdhjetë) % e vlerës totale të faturave tatimore, për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme, por jo më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë për dynym në rastin e dy mbjelljeve në vit.

Për fermerët individualë, që aplikojnë për mbështetje për kontrollin biologjik, sipërfaqja minimale e kultivuar është 1 (një) dynym, ndërsa për aplikantët me status “SHBB” sipërfaqja minimale është 1 (një) ha, për secilën nga mbjelljet.

i. Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik:

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

b) Aplikantët të kësaj mase janë fermerë që kultivojnë perime (domate, specat, tranguj) në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike;

c) Aplikanti fermer individual të ketë jo më pak se 1 (një) dynym sipërfaqe të mbjellë me perime (domate, specat, tranguj) në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike dhe zbaton kontrollin biologjik ndaj dëmtuesve të tyre, ndërsa për aplikantët me status “SHBB”, sipërfaqja minimale është 1 (një) ha, për secilën nga mbjelljet;

ç) Toka të jetë në pronësi të aplikantit dhe/ose me qira jo më pak se një vit, përfshirë edhe vitin e aplikimit;

d) Të ketë faturë për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme (vetëm për fermerët që përdorin kontrollin biologjik të dëmtuesve).

dh) Përfituesi nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së dhe AZHBR-së.

ii. Angazhimi për përmbushjen e kushtëzimeve

Angazhimet për përmbushjen e kushtëzimeve për masën nr. 5, të jenë në përputhje me Aneksin 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

iii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e përfituesve

a) Dokumentacioni i pronësisë apo marrjes me qira të tokës.

Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

- Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;
- Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale/skicën ose plan-vendosjen, të vërtetuar nga DAMT ose Njësia Administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia e shumicës së anëtarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve (shoqëruar me dokumentet përkatëse të pronësisë). Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se një vit, përfshirë edhe vitin e aplikimit;

b) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Aplikanti duhet të dorëzojë dokumentacionin, përfshirë edhe atë të specifikuar në listën e përfituesve, pranë agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së, brenda 20 ditëve kalendarike pas publikimit të saj.

iv. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit në terren:

a) Faturat për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme që përdoren për kontrollin biologjik të dëmtuesve.

b) Vërtetim nga AKVMB-ja/AREB-ja për përdorimin e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme që përdoren për kontrollin biologjik të dëmtuesve.

c) Vërtetim nga AKVMB-ja për plotësimin e regjistrit të përdorimit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve (PMB-ve).

ç) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit, nëse nuk është dorëzuar më parë.

Në rastet kur dokumentet e mësipërme aplikanti nuk i disponon në momentin e verifikimit, mund t'i dorëzojë pranë agropikës më të afërt, zyrës qendrore të AZHBR-së fizikisht ose me postë. Këto dokumente skanohen dhe ngarkohen në sistem.

Masa 6. Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar.

i. Kritere specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik:

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

b) Përfitojnë të gjithë aplikuesit që janë në sistem/skemë certifikimi, në kalim (viti parë, viti i dytë dhe ose viti i tretë) ose të certifikuar organik, me kusht që sipërfaqja e mbjellë që certifikohet të mos jetë më e vogël se 0.5 ha;

c) Toka të jetë në pronësi të aplikuesit, në përdorim ose me qira për të paktën 5 vjet, përfshirë edhe vitin e aplikimit.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në Listën e përfituesve:

a) Kontrata e lidhur nga aplikuesi me një trupë kontrolli të miratuar nga MBZHR-ja ose që ka njoftuar aktivitetin në MBZHR, për specien/speciet dhe sipërfaqen e kultivuar;

b) Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo marrjes me qira.

Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

- Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;
- Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale/skicën ose plan-vendosjen, të vërtetuar nga DAMT-ja ose njësia administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia e shumicës së anëtarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve. shoqëruar me dokumentet përkatëse të pronësisë. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë edhe vitin e aplikimit.

c) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Aplikanti të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e përfituesve brenda 20 ditëve kalendarike pas publikimit të kësaj liste.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit:

a) Dokumentet e certifikimit sipas ligjit shqiptar dhe/ose standardit evropian (certifikatë për statusin e certifikimit dhe anekset e certifikatës ku tregohet kultura e certifikuar) lëshuar nga një trupë kontrolli të miratuar nga MBZHR-ja ose që ka njoftuar aktivitetin në MBZHR:

- AZHBR-ja akseson dokumentet e certifikimit nga faqja zyrtare e trupës certifikuese;
- Kur dokumentet e certifikimit nuk janë të disponueshme në faqen zyrtare të trupës së certifikimit, ato dorëzohen nga aplikanti;

- Lista e trupave të kontrollit që certifikojnë sipas ligjit shqiptar ose standardit evropian, gjendet në faqen zyrtare të MBZHR-së:

b) Faturë tatimore e fiskalizuar e trupës certifikuese/ose *invoice*, kur nuk është kompani shqiptare.

c) Transfertë e bankës të subjektit që është certifikuar me vlerën e shërbimit:

ç) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit, nëse nuk është dorëzuar më parë.

Në rastet kur dokumentet e mësipërme aplikanti nuk i disponon në momentin e verifikimit, mund t'i dorëzojë pranë agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së fizikisht ose me postë. Këto dokumente skanohen dhe ngarkohen në sistem.

Masa 7. Implementimi dhe certifikimi Global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore:

i. por jo më shumë se 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për certifikim individual;

ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup me minimum 10 (dhjetë) fermerë të përfshirë;

iii. por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup me minimum 20 (njëzet) fermerë të përfshirë.

i. Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik:

a) Aplikanti mund të jetë prodhues dhe/ose subjekt grumbullues/eksportues i produkteve bujqësore;

b) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv sipas fushës së veprimtarisë për të cilën aplikon, në rastin e aplikimit si grup fermerësh, aplikimi quhet i vlefshëm vetëm nëse të gjithë anëtarët e grupit kanë NIPT në status aktiv;

c) Aplikanti për certifikim individual mund të përfitojë një certifikatë, e cila mund të përmbajë më shumë se një produkt, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për një ose më shumë kultura të mbjella;

ç) Aplikanti për certifikim në grup mund të përfitojë një certifikatë, e cila mund të përmbajë më shumë se një fermer prodhues në vendndodhje të ndryshme si dhe produkte të ndryshme;

d) Në rastin e aplikimit për certifikim në grup duhet të ketë marrëveshje dakordësie të aplikantit dhe prodhuesve, e cila përmban sipërfaqen e mbjellë, vendndodhjen e fermës të secilit prej tyre, si dhe dokumentet e pronësisë, apo të marrjes me qira për tokën bujqësore;

dh) Aplikanti duhet të jetë në procedurë certifikimi me një trupë certifikimi (shqiptare ose e huaj) të akredituar dhe aprovuar nga Global GAP;

e) Aplikanti të ndjekë procedurën e miratuar deri në marrjen e certifikatës Global GAP;

ë) Certifikata të ketë elemente të verifikueshme *online*, për operatorin, trupën e certifikimit dhe organizmin akreditues në faqen zyrtare të Global GAP.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në Listën e përfituesve:

a) Kontrata e lidhur nga aplikanti me trupën e certifikimit të akredituar dhe aprovuar nga Global GAP;

b) Marrëveshja e dakordësisë së anëtarëve të certifikimit në grup (prodhuesve) me aplikantin. Dokumenti duhet të përmbajë sipërfaqen e secilit anëtar të grupit, vendndodhjen e fermës, si dhe dokumentet e pronësisë apo të marrjes me qira për tokën bujqësore për secilin prodhues.

Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

- certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale/skicën ose plan-vendosjen, të vërtetuar nga DAMT-ja ose njësia administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia e shumicës së anëtarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

- kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve, shoqëruar me dokumentet përkatës të pronësisë.

Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se një vit duke përfshirë edhe vitin e aplikimit;

c) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Aplikanti të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e përfituesve brenda 20 ditë kalendarike pas publikimit të kësaj liste.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit:

a) Certifikatë fotokopje e noterizuar dhe në gjuhën shqipe, që vërteton llojin e prodhimit të certifikuar si Global GAP, të lëshuar nga trupa e certifikimit e akredituar dhe aprovuar nga Global GAP;

b) Faturë tatimore për kostot e procesit të implementimit (kostot e konsulencës për implementimin Global GAP);

c) Faturë tatimore për koston e procesit të certifikimit (tarifat e trupës certifikuese, tarifat e Global GAP dhe të analizave të produkteve, tokës dhe ujit për ujitje);

ç) Transferti të bankës/SWIFT për faturat e mësipërme nga subjekti që është certifikuar;

d) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit, nëse nuk është dorëzuar më parë;

Në rastet kur dokumentet e mësipërme aplikanti nuk i disponon në momentin e verifikimit, mund t'i dorëzojë pranë agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së, fizikisht ose me postë, ose nëpërmjet e-Albania. Këto dokumente skanohen dhe ngarkohen në sistem.

Masa 9. Mbështetje për aktivitetin ripopullim peshkimi për ujërat e brendshme për blerje rasate peshku. Masa e përfitimit të jetë në 50 (pesëdhjetë) % e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë për subjekt.

f) Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Person fizik ose juridik:

a) Aplikanti duhet të ketë një kontratë të vlefshme me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)/Bashkinë, me objekt zhvillimin e aktivitetit të ripopullimit të peshkimit në një objekt ujor;

b) Aplikanti, me status person fizik/juridik, duhet të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për fushën e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikon, si dhe me status aktiv;

c) Aplikanti duhet të ketë faturë tatimore të fiskalizuar për periudhën janar–nëntor 2026 për blerjen e rasateve të peshkut nga subjekt që e ka të parashikuar këtë aktivitet në fushën e veprimtarisë;

ç) Aplikanti duhet të ketë bërë pagesën e taksës vjetore për aktivitetin e ripopullimit të peshkimit;

d) Përfituesi nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së dhe AZHBR-së.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e përfituesve:

a) Kontrata e vlefshme me MBZHR për zhvillimin e aktivitetit të ripopullimit të peshkimit në objektin ujor;

b) Dokument që vërteton regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe statusin aktiv të aplikantit;

c) Fatura tatimore e fiskalizuar për periudhën janar–nëntor 2026 për blerjen e rasateve të peshkut;

ç) Vërtetim nga DSHPA-ja për pagesën e taksës vjetore për aktivitetin e ripopullimit të peshkimit;

d) Vërtetim që përfituesi nuk është debitor ndaj MBZHR-së dhe AZHBR-së;

dh) Vërtetim nga banka e nivelit të dytë për numrin e llogarisë aktive ku do të bëhet pagesa.

Aplikanti të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e përfituesve brenda 20 ditë kalendarike pas publikimit të kësaj liste.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit në terren:

a) Fatura tatimore e fiskalizuar për periudhën janar–nëntor 2026 për blerjen e rasateve të peshkut, në rast se nuk është dorëzuar pas përfshirjes në Listën e përfituesve;

b) Dokumentacion që provon realizimin e aktivitetit të ripopullimit të peshkimit në objektin ujor, sipas kontratës me MBZHR-në, të lëshuar nga DSHPA-ja.

Në rastet kur dokumentet e mësipërme aplikanti nuk i disponon në momentin e verifikimit, ai mund t'i dorëzojë pranë agropikës më të afërt ose në zyrën qendrore të AZHBR-së, fizikisht ose me postë. Këto dokumente skanohen dhe ngarkohen në sistem.

VII. PROCEDURA E APLIKIMIT PËR MASAT ME NR. 1, NR. 2, NR. 3, NR. 4, NR. 5, NR. 6, NR. 7 DHE NR. 9

Aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor kryen regjistrimin e biznesit në portalin *e-Albania*. Pas regjistrimit, aplikantit i shfaqet në sistem dritarja “Aplikim për Skemat Kombëtare”. Aplikanti plotëson NIPT-in e fermerit, përzgjedh masën mbështetëse dhe plotëson (vetë deklaron) sasinë që ka (krerë, zgjoje, sipërfaqe) dhe jep komandën “dërgo”.

Rubrikat që shfaqen në sistem janë:

1. Masa mbështetëse.
2. Të dhënat e kartës së identitetit të aplikantit (në rast kur ka përfaqësues, të dhënat në formular të jenë ato të aplikantit).
3. Statusi nëse aplikanti ka NIPT aktiv.
4. Vendndodhja e aplikimit.
5. Sasia e aplikuar (krerë/zgjoje/sipërfaqja në ha).
6. Vlera maksimale e përfitimit.
7. Numër kontakti.
8. Kodi i aplikimit dhe koha e regjistrimit në sistem, të cilat gjenerohen automatikisht nga sistemi.
9. Aplikanti pranon që të dhënat e tij personale të përdoren vetëm për qëllim të këtij aplikimi. AZHBR-ja garanton mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve sipas ligjeve në fuqi.
10. Aplikanti informohet se nuk mund të përfitojë nëse është debitor ndaj AZHBR-së, dhe/ose MBZHR-së, dhe/ose nuk ka derdhur detyrimet koherente për sigurimet shoqërore.
11. Llogaria bankare e aplikantit/përfituesit.
12. Angazhimi për përmbushjen e kushtëzimeve për masën mbështetëse.

Procedura e aplikimit përfundon me mesazhin në sistem “Aplikimi u regjistrua me sukses”.

VIII. PROCEDURA QË NDIQET PËR PËRZGJEDHJEN, VERIFIKIMIN DHE PAGESAT PËR MASAT MBËSHTETËSE ME NR. 1, NR. 2, NR. 3, NR. 4, NR. 5, NR. 6, NR. 7 DHE NR. 9

1. Përveç sa përcaktohet në kreun IV, “Informacion i përgjithshëm për aplikimin”, ***aplikimi*** për masat mbështetëse 1, 2 dhe 4 bëhet mbi bazën e numrit të lopëve/mëshqerrave, të deleve dhe/ose dhive të tufës bazë ekzistuese, përfshirë edhe kafshët riprodhuese meshkuj, të dosave dhe/ose paradosave, ndërsa për masën 3 për numrin e zgjojeve që mbarështohen, të vërtetuar nga sistemi RUDA/AKVMB.

Në rastet kur numri i krerëve/zgjojeve të aplikuar në masat –4 është më i madh se numri përkatës që rezulton në sistemin RUDA në datën e aplikimit, AZHBR-ja kërkon nga AKVMB-ja konfirmim zyrtar nëse krerët/zgjojet kanë qenë të matrikulluara faktikisht deri në datën e aplikimit.

Konfirmimi i AKVMB-së, që krerët/zgjojet kanë qenë të matrikulluara deri në datën e aplikimit shërben si referencë për vlerësimin e aplikimit.

Aplikimi për masën mbështetëse nr. 5 bëhet mbi bazën e sipërfaqes që kultivohet dhe që zbatohet kontrolli biologjik i dëmtuesve.

Pagesa, për masat 1, 2, 3 dhe 4 bëhet sipas numrit të krerëve/zgjojeve që rezultojnë në sistemin RUDA në kohën e pagesës, ndërsa për aplikantët që kryhet edhe verifikimi në terren, pagesa bëhet sipas numrit faktik të krerëve/zgjojeve që rezultojnë gjatë verifikimit. Në të dyja rastet, pagesa nuk duhet të jetë më e madhe se sa vlera e përlogaritur sipas numrit të krerëve/zgjojeve, që rezulton në sistem në datën që është bërë aplikimi.

Aplikantët, të cilët nuk kanë numrin minimal të krerëve/zgjojeve, sipas masës përkatëse në ditën e aplikimit në sistemin RUDA, në ditën e verifikimit në terren, apo para pagesës në sistemin RUDA, nuk përfitojnë pagesë.

Aplikantët për masat 1, 2, 3 dhe 4 duhet të njoftojnë me shkrim për çdo pakësim në numrin e krerëve/zgjojeve të aplikuar, që mund të ndodhë pas aplikimit deri në datën kur kryhet pagesa ose kontrolli (për subjektet që mund të kontrollohen para pagesës), nëse këto pakësime nuk janë reflektuar në sistemin RUDA. Për pakësimet e njoftuara të numrit të krerëve/zgjojeve bëhet zbritja e vlerës përkatëse të përfitimit.

Njoftimet e aplikantëve për pakësimet e numrit të krerëve/zgjojeve mund të dorëzohen në agropika, në zyrat qendrore të AZHBR-së fizikisht ose me postë.

Kontrolli në terren (për masat 1, 2, 3 dhe 4) për verifikimin faktik të numrit të krerëve/zgjojeve kryhet në jo më pak se 30% të subjekteve përfituese.

Në masën 3, për aplikantët me më pak se 50 zgjoje, që përfshihen për herë të parë në skemë, verifikimi në terren kryhet bazuar në verifikimin, sipas regjistrat të fermës blegtorale, në sistemin RUDA.

Në rastet kur, gjatë verifikimit në terren, rezulton se vlera që përfitohet e kalon masën 20%, të përlogaritur mbi bazën e numrit të krerëve/zgjojeve në ditën e aplikimit, korrigjohet edhe me pakësimet eventuale nëpërmjet njoftimit apo të reflektuara në sistem, procedohet sipas përcaktimeve të pikës 6, të VKM-së nr. 205, datë 30.3.2026.

Subjekti shpallet edhe debitor për vlerën e përfituar (të kaluar në llogarinë bankare) në mënyrë të padrejtë ose i zbritet nga pagesa në rastin kur kontrolli kryhet para pagesës.

Pagesa, për masën nr. 5, bëhet pas verifikimit në terren për sipërfaqen faktike të mbjellë që zbatohet kontrolli biologjik i dëmtuesve.

2. Me përfundimin e fazës së aplikimit, sistemi gjeneron automatikisht listat e aplikantëve për çdo masë mbështetëse.

3. Me përfundimin e aplikimeve dhe kontrollit administrativ të dokumenteve që gjenerohen online, AZHBR shpall brenda 20 ditëve kalendarike, listën e aplikimeve të përfituesve dhe dokumentet e kërkuara sipas masës përkatëse, në faqen zyrtare të saj: www.azhbr.gov.al.

4. Aplikantët, sipas evidentimeve në listën e shpallur, sipas afateve të përcaktuar dorëzojnë dokumentet e kërkuara në agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së fizikisht ose me postë, ose mund t'i ngarkojnë në *e-Albania*. Vetëm dokumenti i llogarisë bankare mund të dorëzohet deri para kryerjes së pagesës.

5. Inspektori/specialisti i agropikës për çdo dokument të paraqitur nga aplikanti/përfaqësuesi ligjor apo çdo dokument tjetër të gjeneruar nga regjistrat publikë, mban procesverbal në dy kopje, të marrjes në dorëzim të dokumenteve dhe i dërgon në AZHBR, Tiranë.

6. Dosja origjinale transferohet nga zyrat e aplikimit në AZHBR përmes protokollit në sektorin e SPAP/AZHBR.

7. DPAP/SPAP bën kontrollin administrativ të dokumentacionit, si të atyre që gjenerohen nga sistemi online dhe të atyre që ndodhen në dosjen e aplikimit dhe në përputhje me kriteret, aprovon/skualifikon aplikimet përkatëse.

8. Grupi i verifikimit në terren në prani të aplikantit ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit sipas masës përkatëse. Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikanti/përfaqësuesi ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë.

9. Kur grupi i verifikimit ka qëndrime të ndryshme, në lidhje me gjetjet faktike në terren, një ekip i Drejtorisë së Kontrollit të AZHBR-së qendër, bën rivefikim të rastit, vendimi i argumentuar i të cilit është i pakontestueshëm administrativisht nga palët.

10. Në momentin e verifikimit aplikanti/përfaqësuesi ligjor i dorëzon grupit të verifikimit dokumentet e nevojshme të parashikuara në këtë udhëzim.

11. Procedurat e pranimit, procesit të aplikimit dhe verifikimeve përcaktohen në Manualin e Procedurave të Implementimit të Skemës Kombëtare 2026.

12. Në këtë manual përcaktohen edhe afatet konkrete për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve, shpalljen e listës përfundimtare të fituesve, kohën dhe mënyrën e disbursimit të fondeve të përfituesit.

13. Për aplikimet e skualifikuara nga kontrollet administrative dhe në terren, AZHBR-ja shpall në faqen zyrtare të internetit listën e subjekteve të skualifikuara me arsyet e skualifikimit.

14. Aplikimi, kontrolli administrativ, verifikimi në terren, autorizimi, ekzekutimi i pagesës për masat nr. 1–nr. 7 dhe nr. 9 përshkruhen në “Manualin e procedurave për implementimin e masave direkte viti 2026” të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AZHBR-së”.

IX. KRITERET, DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR MASËN NR. 8.

Masa 8. Pagesa, në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për ha sipërfaqe të mbjellë me kultura bujqësore. Sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 3 (tre) ha.

Për sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.

Kriteret e përfitimit:

1. Masa e mbështetjes zbatohet për sipërfaqe të mbjella me kultura bujqësore. Çdo subjekt përfitues, duhet të provojë se ka tokë bujqësore në pronësi apo përdorim, sipas përcaktimeve dhe dokumentacionit të kërkuar në këtë udhëzim.

2. Aplikanti vetëdeklaron kulturat bujqësore të mbjella ose që parashikon të mbjellë, sipas përcaktimeve të formularit të aplikimit *online*. Çdo parcelë, sipas dokumentacionit të pronësisë, apo përdorimit, plotësohet me kulturën/kulturat përkatëse të mbjellë ose që parashikohen të mbillen.

3. Çdo subjekt përfitues duhet të ngarkojë në sistem në momentin e aplikimit ose të dorëzojë pranë zyrave të AREB-ve, ose në agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së fizikisht ose me postë, ose nëpërmjet sistemit *e-Albania* deri para pagesës apo para kontrollit (për subjektet që mund të kontrollohen para pagesës):

- kopje të faturave për shitjen e prodhimit; ose
- faturë blerje për një nga imputet si material mbjellës (farëra ose fidanë)/plehra kimike/pesticide.

4. Për të gjitha llojet e subjekteve përfituese madhësia minimale e sipërfaqes së mbjellë me kultura bujqësore duhet të jetë jo më pak se 3 (tre) ha.

5. Përfitimi në vlerë, për sipërfaqen që kultivohet është, si më poshtë vijon:

- i. deri në 100% të vlerës, për fermerët/aplikantët me sipërfaqe deri në 10 ha;
- ii. Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”, të cilët përfitojnë 100% të vlerës.

Angazhimi për përmbushjen e kushtëzimeve

Angazhimet për përmbushjen e kushtëzimeve për masën nr. 8, të jenë në përputhje me aneksin 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Aplikimi:

1. Çdo subjekt që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, duhet të bëjë aplikimin *online*, duke plotësuar të dhënat nëpërmjet vetëdeklarimit dhe duke ngarkuar në sistem dokumentacionin e kërkuar.

2. Formulari i aplikimit *online* nëpërmjet *e-Albania* plotësohet nga aplikanti mbi bazë vetëdeklarimi, në lidhje me:

a) parcelat që kultivohen gjatë vitit (mbjelljet e para);

b) kulturat e mbjella apo që do të mbillen në ato parcela gjatë vitit (mbjelljet e para).

3. Deklarimi i sipërfaqeve të mbjella nga aplikanti bëhet si vijon:

Fermeri do të deklarojë sipërfaqet e mbjelljeve të para të kulturave bujqësore, që përfshin mbjelljet në periudhën e vjeshtës dhe të pranverës (1 tetor 2025 deri më 31 maj 2026).

Deklarimi i mbjelljeve nga aplikanti, bëhet si vijon:

a) Për perimet e serrës, fermeri do të deklarojë sipërfaqet që ka të mbjella me perime serre në momentin e aplikimit dhe/ose sipërfaqet që do të mbjellë deri më 31 maj 2026.

b) Për drufrutorët, fermeri do të deklarojë sipërfaqen ekzistuese të mbjellë me këto bimë në momentin e kryerjes së aplikimit, si dhe sipërfaqet që do të mbillen deri më 31 maj, 2026, me kusht që sipërfaqet e reja të mos jenë zëvendësime të sipërfaqeve të deklaruara të mbjella me të njëjtat bimë ose me bimë të tjera.

c) Për kulturat në fushë të hapur, për bimët njëvjeçare të arave dhe perimet e fushës, fermeri do të deklarojë sipërfaqet: i. me bimët e arave të mbjella në vjeshtën 2025 (fakt në momentin e aplikimit) dhe/ose që do të mbillen deri më 31 maj 2026; ii. me perimet e fushës që ka mbjellë (fakt në momentin e aplikimit) ose që do të mbjellë deri në 31 maj 2026.

Në rastin e bimëve bashkëshoqëruese, sipërfaqja do të deklarohet vetëm një herë, vetëm për bimën kryesore. Për bimët foragjere shumëvjeçare dhe bimët aromatike-mjekësore, fermeri do të deklarojë sipërfaqen e mbjellë me këto bimë në momentin e kryerjes së deklarimit, si dhe sipërfaqet që do të mbillen deri 31 maj 2026, me kushtet e përcaktuara në pikën “b” për drufrutorët. Kulturat bujqësore/grup-kulturat që mbështeten nga kjo masë përcaktohen në aneksin 8.

4. Gjatë aplikimit *online*, çdo dokument i kërkuar, sipas këtij udhëzimi, do të skanohet dhe ngarkohet në mënyrë elektronike, me përjashtim të dokumentit/dokumenteve që ofrohen automatikisht nga portali *e-Albania*).

5. Dokumentacioni i kërkuar për t’u ngarkuar *online*, sipas këtij udhëzimi, duhet të jetë në origjinal ose i noterizuar, si dhe të jetë në gjuhën shqipe ose, në rast se është në gjuhë të huaj, të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

6. Dokumentacioni i pronësisë së tokës (certifikata) i ngarkuar në sistem do të konsiderohet i vlefshëm nëse gjatë kontrollit administrativ konfirmohet nga ASHK-ja.

Në rastin kur në sistem ngarkohet AMPT-ja do të konsiderohet e vlefshme nëse gjatë kontrollit administrativ konfirmohet nga ASHK-ja ose njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV).

Të vlefshme konsiderohen edhe konfirmimet për dokumentacionin e pronësisë (certifikatë ose AMTP), të bëra në aplikimet në vitet 2024 dhe 2025, si dhe konfirmimet për dokumentacionin e përdorimi të tokës bujqësore me afat të vlefshëm edhe për vitin 2026.

7. Dokumentacioni që duhet të ngarkohet në sistem është në varësi të statusit të pronësisë apo përdorimit të tokës bujqësore për të cilën aplikohet dhe statusit të regjistrimit të saj në ASHK. Në mënyrë të përmblodhur, dokumentacioni i kërkuar sipas skenarëve të ndryshëm, është si më poshtë:

Skenari	Dokumentacioni i skanuar që duhet të ngarkohet nga aplikuesi
---------	--

Aplikanti e ka në pronësi tokën bujqësore (në emër të tij) dhe ka marrë certifikatën e pronësisë.	Certifikatën e pronësisë
Aplikanti ka AMTP për tokën bujqësore të lëshuar në emër të tij si përfaqësues i familjes bujqësore.	AMTP
Aplikanti është anëtar i familjes bujqësore që ka marrë tokën në pronësi.	AMTP Certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991. Marrëveshje dakordësie e shumicës së anëtarëve të familjes bujqësore në gjendjen aktuale, në lidhje me punimin/përdorimin e tokës nga aplikuesi.
Aplikanti e ka marrë tokën bujqësore me qira ose në përdorim.	Kontratë qiraje, kontratë huapërdorjeje ose dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve (shoqëruar me dokumentet përkatëse të pronësisë).

8. Kontratat e vlefshme të qiramarrjes, të cilat duhet të përfshijnë edhe vitin 2026, të lidhura me ish-drejtoritë e bujqësisë, MBZHR-në ose komunat/bashkitë, kanë të njëjtën vlerë me ato të bëra pranë noterit publik.

9. Kur gjatë kontrollit administrativ të dokumentacionit, sipërfaqet e parcelave, sipas AMTP-së rezultojnë me diferenca me ato sipas ASHK-së/NJVV-së, merren në konsideratë të dhënat e ASHK-së/NJVV-së.

10. Marrëveshje dakordësie kërkohet edhe në rastet kur aplikanti është njëri prej bashkëpronarëve sipas AMTP-së/certifikatës së pronësisë së tokës bujqësore. Modeli tip i marrëveshjes së dakordësisë jepet në aneksin 9, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Kur certifikata e pronësisë së tokës bujqësore është në pronësi të personit/ve të ndryshëm nga aplikanti, kërkohet kontratë qiraje/huapërdorjeje, pavarësisht se aplikanti mund të jetë anëtar i së njëjtës familje, por nuk është një prej bashkëpronarëve në dokumentin e pronësisë.

12. Nëse Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), i ngarkuar në sistem nga aplikuesi, nuk konfirmohet nga ASHK-ja, kërkohet konfirmim zyrtar të këtij dokumenti me sipërfaqen totale dhe sipërfaqen e parcelave nga njësia administrative/bashkia përkatëse. Përgjigjja pozitive/negative ngarkohet në sistem.

13. Do të konsiderohen të vlefshme edhe kontratat e qiramarrjes/huapërdorjes/dokument të ligjshëm të firmosur nga palët. Në rast se kontrata ose dokumenti janë të panoterizuara duhet të jetë i konfirmuar nga njësia administrative dhe të përfshijë dokument identifikimi të palëve. Ato përmbajnë sipërfaqen totale dhe të parcelave të tokës bujqësore objekt qiramarrjeje/huapërdorje, si dhe vendndodhjen e secilës parcelë. Kontrata/dokumentit përfshin edhe të drejtën e përdorimit të tokës për vitin 2026.

Gjithashtu, të vlefshme do të konsiderohen edhe rastet kur dokumentet e sipërcituara nënshkruhen nga njëri prej anëtarëve të familjes bujqësore në gjendjen aktuale (shoqëruar me dokumentet përkatëse të pronësisë).

14. Procedura e aplikimit nëpërmjet portalit *e-Albania* përfundon me dërgimin e suksesshëm të formatit elektronik të formularit të aplikimit në sistem dhe aplikuesi njoftohet me mesazh elektronik.

Aplikimi elektronik programohet në mënyrë që të mos lejojë vazhdimin e plotësimit të aplikimit, nëse nuk përmbushen kriteret bazë të kualifikimit, në lidhje me madhësinë e sipërfaqes totale të deklaruar, madhësinë e parcelave, kulturat e mbjella dhe tipin e dokumentacionit në lidhje me tokën bujqësore.

15. Të gjitha aplikimet e kryera nëpërmjet *e-Albania*, i nënshtrohen procesit të kontrollit administrativ, që shqyrton përputhjet e vetëdeklarimeve, në lidhje me parcelat, sipërfaqet, kulturat dhe dokumentacionin që i mbështet këto deklarime.

16. Pas kontrollit administrativ, aplikanti njoftohet mbi rezultatin e aplikimit (i kualifikuar/i skualifikuar).

17. Informacion i nevojshëm për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe të procedimit deri në përfitimin e vlerës përkatëse të mbështetjes, do të ofrohet pranë AREB-ve, pranë agropikave, si dhe në faqet zyrtare të internetit të AZHBR-së.

Procedura që ndiqet për kualifikimin, vlerësimin, përfitimin e mbështetjes dhe kontrollin:

1. Kontrolli administrativ i vetëdeklarimit dhe i dokumentacionit të aplikantit, të ngarkuar/gjeneruar nga sistemi *online* ose të administruara shkresërisht bëhet nga punonjësi i ngarkuar për kontrollin. Në përputhje me kriteret, bëhet miratimi/skualifikimi i aplikimeve përkatëse dhe përllogaritet vlera që përfiton aplikanti.

2. Punonjësit e ngarkuar për kontrollin administrativ për zgjidhen nga stafi i AREB-eve dhe AZHBR-së. Lista e punonjësve për kontrollin administrativ miratohet nga drejtori i përgjithshëm i AZHBR-së.

3. Punonjësit që do të merren me kontrollin administrativ, aksesojnë aplikimet *online* nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, me anë të kredencialeve të përcaktuara nga *e-Albania/AKSHI*.

4. Gjatë kontrollit administrativ shqyrtohet përputhja e vetëdeklarimeve, në lidhje me parcelat, sipërfaqet, kulturat dhe dokumentacionin që i mbështet këto deklaramë:

a) nëse dokumentacioni i ngarkuar në aplikim është dokumentacioni i duhur, me karakteristikat dhe elementet e kërkuara sipas këtij udhëzimi;

b) nëse të dhënat e dokumentacionit të ngarkuar në aplikim, përkojnë me të dhënat e identitetit të aplikuesit.

Pas kontrollit, sipas shkronjës “a” dhe shkronjës “b”, punonjësi që bën kontrollin lë një shënim në sistem:

i. duke konfirmuar që dokumentacioni i ngarkuar **ËSHTË** sipas kërkesave që lidhen me llojin e dokumentacionit;

ii. duke konfirmuar që dokumentacioni i ngarkuar **NUK ËSHTË** sipas kërkesave mbi llojin e dokumentacionit; në këtë rast punonjësi shënon në sistem çfarë problematike ka ky dokumentacion;

c) nëse sipërfaqet e vetëdeklaruara për mbjellje janë të mbështetura me dokumentacionin e duhur pronësor apo të përdorimit të tokës; për këtë, punonjësi kontrollon formularin e aplikimit për sipërfaqet e çdo parcele dhe verifikon nëse parcela është në dokumentet e ngarkuara në sistem dhe e konfirmuar me vërtetimin “pozitiv/negativ” nga ASHK-ja/NJVV-ja;

ç) gabime të tjera të mundshme.

Pas kontrollit, sipas shkronjës “c” dhe shkronjës “d”, punonjësi lë një shënim në sistem, duke:

i. konfirmuar që sipërfaqet dhe mbjelljet e deklaruara **JANË** sipas kërkesave të këtij udhëzimi dhe të bazuara në dokumentacion;

ii. konfirmuar që sipërfaqet dhe mbjelljet e deklaruara **NUK JANË** sipas kërkesave të këtij udhëzimi dhe nuk janë të bazuara në dokumentacion; në këtë rast, punonjësi shënon në sistem arsyet e këtij konstatimi dhe do të kërkojë nga aplikuesi, që të plotësojë dokumentacionin në afatin e përcaktuar sipas këtij udhëzimi;

iii. shënime mbi gabime të tjera, të identifikuar nga punonjësi që kryen kontrollin.

5. Në përfundim të procesit të verifikimit administrativ të mësipërm, aplikanti njoftohet për një nga situatat e mundshme si më poshtë:

a) aplikimi është gjykuar i vlefshëm dhe ka kaluar në fazën e përllogaritjes së përfitimit të vlerës përkatëse;

b) aplikimi ka mangësi dhe kërkon veprime shtesë nga aplikanti, të cilat ai duhet t'i kryejë brenda 10 ditëve kalendarike, nga momenti i njoftimit.

6. Pas kthimit të përgjigjes elektronike nga aplikanti ose në mungesë të kësaj përgjigjeje brenda afateve zyrtare, në lidhje me plotësimet dokumentare, apo plotësimet e fushave të caktuara të formës në afatin e kërkuar, punonjësi që ka trajtuar aplikimin përkatës bën ndryshimet e nevojshme në formën dhe dokumentacionin, dhe në bazë të informacionit shtesë të paraqitur ose mungesës së tij, merr vendimet e mëposhtme:

a) aplikimi gjykohet i vlefshëm në mënyrë tërësore;

b) aplikimi gjykohet i vlefshëm në mënyrë pjesore (vetëm për ato sipërfaqe dhe të mbjella që kanë rezultuar në respektim të kërkesave të këtij udhëzimi);

c) aplikimi refuzohet.

7. Aplikimet me statusin përkatës, sipas pikës 6 më sipër, i kalojnë për miratim DPAP-së. AZHBR-ja konfirmon aplikimet sipas statusit dhe njëkohësisht mund të kryejë rikontroll administrativ me analizë risku bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e faktorëve, të përshkruar në Manualin e procedurave për implementimin e masave direkte viti 2026.

Nëse gjatë këtyre rezulton se aplikimi nuk plotëson kriteret e përfitimit, AZHBR-ja kthen aplikimin për rikontroll/dokumente shtesë te punonjësi që ka bërë kontrollin, duke lënë shënim të arsyetuar në sistem mbi mangësitë e konstatuara ose konfirmon aplikimin në rastin kur është i plotë.

8. Në përfundim të procesit të kontrollit administrativ përgatitet lista e aplikimeve të përfituesve si dhe lista e aplikimeve të skualifikuara.

9. Për menaxhimin e procesit për mbështetjen e fermerëve nga kjo masë mbështetëse përdoret Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (SMI), i cili mundëson:

a) menaxhimin e aplikimeve *online*, duke mundësuar/lehtësuar grumbullimin dhe shqyrtimin administrativ të tyre;

b) përllogaritjen e vlerën përkatëse që përfitohet, mbështetur në vetëdeklarim dhe duke u bazuar te sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjella të deklaruara;

c) përzgjedhjen e subjekteve përfituese që do t'i nënshtrohen kontrollit në terren;

ç) menaxhimin e procesit të kontrollit në terren që do të vlerësojë përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale në terren;

d) gjenerimin e raportimeve të ndryshme në faza të caktuara të procesit.

10. Lista e përfituesve me vlerën përkatëse (në lekë) të përllogaritur për subjektet përfitues publikohet në faqen zyrtare të internetit të AZHBR-së.

11. Pas shpalljes së listës së përfituesve kryhen kontrollet në terren dhe vazhdojnë në varësi të periudhave të deklaruara për mbjelljen e kulturave; çdo subjekt përfitues i pagesave është subjekt potencial kontrolli.

12. Kontrolli në terren i subjekteve përfituese mund të jetë i plotë ose me zgjedhje rastësore. Kontrolli do të jetë i plotë për të gjitha subjektet përfituese me sipërfaqe mbi 10 ha dhe me zgjedhje rastësore për subjektet përfituese me sipërfaqe deri në 10 ha.

Kontrolli në terren do të kryhet sipas analizës së riskut bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e faktorëve si sipërfaqja e aplikuar, kulturat dhe/ose sezonaliteti i tyre, numrin e parcelave të aplikuara etj., të përshkruar në “Manualin e procedurave për implementimin e masave kombëtare” të AZHBR-së.

Kontrolli në terren duhet të bëhet për jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e të gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha si dhe subjektet me statusin “SHBB”.

13. Grupi i kontrollit në terren bën verifikimin në vend, duke lajmëruar paraprakisht subjektin përfitues për praninë e tij ose përfaqësuesin ligjor të pajisur me prokurë; grupi i kontrollit

paraqitet te subjekti përfitues për t'u kontrolluar me formularin e vetëdeklarimit të sipërfaqeve të planifikuara për t'u kultivuar prej tij.

14. Grupi i kontrollit, në prani të subjektit përfitues ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson raportin e verifikimit; raporti i verifikimit firmoset nga subjekti përfitues/përfaqësuesi i tij ligjor dhe i gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast që subjekti përfitues nuk pranon vendimin e grupit të verifikimit, ai mund të bëjë shënimet/komentet e nevojshme dhe të firmosë për to. Formularët/raportet e verifikimit në terren, përgatiten sipas aneksit 10, në përputhje dhe në zbatim të këtij udhëzimi.

15. Kur grupi i verifikimit ka mendime të ndryshme me subjektin përfitues, në lidhje me gjetjet faktike në terren, përkundrejt formularit të vetëdeklarimit, një ekip i Drejtorisë së Kontrollit në AZHBR-së, bën riverifikim të rastit, vendimi i argumentuar i të cilit është i përfundimtar nga pikëpamja administrative.

16. Aplikantët duhet të njoftojnë me shkrim në agropika, AREB-ja, zyrat qendrore të AZHBR-së fizikisht ose me postë, për çdo pakësim në sipërfaqen e mbjellë që mund të ndodhë pas aplikimit deri në momentin kur kryhet pagesa ose kontrolli (për subjektet që mund të kontrollohen para pagesës) dhe në këtë rast bëhet zbritja e vlerës përkatëse të përfitimit.

17. Informacioni i raportit të verifikimit ngarkohet në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (SMI), sipas kërkesave të sistemit.

18. Në vlerësimin e përputhshmërisë së vetëdeklarimeve, me situatën reale në terren, shmangia e lejuar e faktit të verifikuar të sipërfaqes së kultivuar, në raport me vlerën në lekë, sipas aplikimit të miratuar, përfshirë edhe pakësimin eventual, sipas njoftimit të mëpasshëm të aplikantit, duhet të jetë jo më e madhe se 20%.

19. Në rast se vlerësohet një devijim më i madh se 20% (sipas përcaktimit të pikës 18 më sipër) dhe subjekti ka përfituar më shumë se 20% nga vlera për të cilën plotëson kriteret, subjekti përfitues:

a) përjashtohet për 3 vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit;

b) shpallet edhe debitor për vlerën e përfituar (të kaluar në llogarinë bankare) në mënyrë të padrejtë ose i zbritet nga pagesa në rastin kur kontrolli kryhet para pagesës.

20. Trajtimi i ankesave bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

21. Procedurat mbi procesin e verifikimeve sipas këtij kreu, përcaktohen në një manual/procedurë të veçantë nga AZHBR-ja.

X. KRITERET SPECIFIKE DHE DOKUMENTACIONI PËR MASAT MBËSHTETËSE NR. 10–12

1. Shpenzime të papranueshme:

- Blerje e truallit apo ndërtesës;
- Shpenzimet e përgjithshme si hartimi i biznesplanit, tarifat e inxhinierëve, arkitektëve, studime fizibiliteti, patenta, licenca etj.;
- Shpenzime operative si transporti i makinerive dhe linjave të ndryshme, elektriciteti, uji, gaz, mirëmbajtje, amortizim dhe kostot e qirasë etj.;
- Detyrimet doganore dhe të importit ose çdo tarifë që ka efekt të njëjtë;
- Blerje, qira ose lizing për tokën apo ndërtesat ekzistuese;
- Gjoha apo detyrime gjyqësore;
- Kostot operative të aktivitetit;
- Mallra, makineri dhe pajisje të përdorura;
- Detyrime bankare si kosto garancish e të tjera të ngjashme;
- Kontributet në natyrë;

- Kosto të shkëmbimit valutor;
- Shpenzime të kryera në objekt para lidhjes së kontratës me AZHBR-në;
- Kosto promovimi për të bërë publik produktin;
- Aplikanti i cili ka dhe menaxhon mbi 25% kapital publik në sipërmarrjen e vet;
- TVSH.

Masa 10. Fermerë të rinj, për investime në ferma bujqësore dhe blegtorale, masa e përfitimit është në 70% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfitues të mundshëm: Fermer individual, subjekt me status fizik/juridik, SHBB:

- a) “Fermer i ri” konsiderohet çdo aplikant i cili, në datën e marrjes së vendimit administrativ për miratimin e mbështetjes financiare, rezulton të jetë nën moshën 40 (dyzet) vjeç;
- b) Aplikanti me status person fizik/juridik duhet të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për fushën e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikon;
- c) Aplikanti me status fermer individual duhet të jenë i pajisur me NIPT fermeri;
- ç) Projekti i investimit duhet të lidhet me veprimtari ekonomike bujqësore (kultivimin e bimëve dhe/ose mbarështimin e kafshëve);
- d) Nëse investimi lidhet me mbarështimin e kafshëve, shpendëve apo bletëve, ato duhet të jenë të regjistruara/matrikulluara para pagesës dhe me një numër jo më pak, se:
 - 5 lopë/mëshqerra;
 - 50 dele dhe/ose dhi;
 - 5 dosa/paradosa për mbarështim;
 - 25 koshere;
 - 500 shpendë (*Gallus gallus domesticus*).
- dh) Nëse investimi lidhet me aktivitet bujqësor, para kërkesës për pagesë aplikanti duhet të ketë tokë të mbjellë, jo më pak se:
 - 0.5 ha tokë pemë frutore/ullinj/vreshta/agrumë;
 - 0,1 ha serra (diellorë, plastikë, xham) ose tunele plastikë të mbjella me perime /luleshtrydhe/rrush tavoline;
- e) Mallrat, sistemet/pajisjet duhet të jenë të reja;
- ë) Investimi për të cilin kërkohet mbështetje nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës;
- f) Në rastet kur investimi për sipërfaqe/krerë të aplikuar kalon vlerën maksimale të përfitimit, aplikimi do të pranohet për t’u financuar deri në masën maksimale të përfitimit, me kusht që pjesa tjetër e investimit të mbulohet nga aplikanti me fondet e veta;
- g) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR-së/MBZHR-së/tatimeve;
- gj) Aplikanti nuk duhet të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë, sipas përcaktimeve të pikës 13, kreu III të këtij udhëzimi.

Investime të pranueshme:

- a) Blerja e kafshëve, por jo më pak, se:
 - 5 lopë/mëshqerra;
 - 50 dele dhe/ose dhi;
 - 5 dosa/pradosa për mbarështim;
 - 25 koshere;
 - 500 shpendë (*Gallus gallus domesticus*);
- b) Shpenzimet për krijimin e pemëtoreve të reja të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe vreshtave, për:
 - kostot e blerjes së materialit mbjellës;

- punimet bazë të tokës, hapja e gropave, tarracimet, vendosja e shtyllave mbështetëse, rrethimi me rrjeta, të kryera nga një palë e tretë;

- sistemi i ujitjes me pika.

c) Ndërtimi i strehimeve të kafshëve për lopë të imta, shpendë, dosa;

ç) Ndërtimi i serrave diellore për perime, rrush tavoline, manaferra dhe tuneleve për luleshtrydhe me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha dhe **jo më shumë se 0.2 ha**;

d) Makineri/pajisje dhe mjete pune për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në funksion të aktivitetit bujqësor dhe/ose blegtoral;

dh) Mbështetje për të përmirësuar proceset e punës në teknologji të reja dhe inovacion, të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, si prodhimi i energjisë nga burime të rinovueshme, dronët dhe mjetet digjitale për bujqësi precize, në fermat bujqësore dhe/ose blegtorale.

ii. Kriteret konkurruese:

- Kualifikimi i aplikantit në fushën e investimit 40 pikë

- Investime në energji të rinovueshme 20 pikë

- Vlera e shpenzimeve të pranueshme 40 pikë

TOTALI 100 pikë

Kualifikimi i aplikantit në fushën e investimit, i dokumentuar me:

- Diplomë e nivelit *Bachelor* në njërin nga fakultetet e Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe të Fakultetit të Agrobiznesit të Universitetit të Korçës;

- Diplomë e shkollës së mesme me profil bujqësor/blegtoral;

- Certifikata pjesëmarrjeje në kurse/trajnime me jo më pak se 50 orë në fushën e bujqësisë në 3 vjetët e fundit.

Vlera e shpenzimeve të pranueshme

Vlerësimin maksimal 40 pikë e fiton subjekti i cili ka vlerën e investimit 2,000,000 lekë.

Aplikimet me vlerën më të vogël se 2,000,000 llogariten në mënyrë proporcionale, sipas formulës:

$X = \text{Vlera e investimit} * 40 / \text{vlerën } 2,000,000 \text{ lekë.}$

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR:

a) Formulari i aplikimit sipas aneksit 11;

b) Dokumentin e regjistrimit në QKB, që vërteton statusin e aplikantit (subjekt me status fizik, juridik, SHBB), nëse nuk gjenerohet nga sistemi.

c) Dëshminë e penaltetit për aplikantët (fermer individual, person fizik dhe aksionarët për aplikantët si person juridik/SHBB), sipas përcaktimeve të pikës 13, kreu III, të këtij udhëzimi. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të aplikimit.

ç) 1 ofertë origjinale, shoqëruar me datë, firmë, vlefshmërinë e ofertës, e firmosur dhe vulosur të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) të subjektit ofertues. Nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë sipas kriterëve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të realizojë. Ofertuesi/t nuk duhet të jetë/jenë në konflikt interesi me njëri-tjetrin dhe me aplikantin;

d) Vërtetimin e lëshuar nga drejtoria e tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet.

dh) Për fermerët individualë, vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të aplikimit;

e) Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e miratimit të njoftimit të punimeve/lejes së ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi; ky dokument mund të dorëzohet deri para lidhjes së kontratës;

ë) Plan-vendosje e strukturës së projektit/leja zhvillimore, preventivi nga personi i licencuar, si dhe i gjeneruar sipas “Hartim preventivi nga manuali i çmimeve në ndërtim” nga *e-Albania*, projekti konstruktiv dhe projekti arkitekturor, për investimet në ndërtim sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dokumentacioni duhet të shoqërohet me licencat përkatëse të arkitektëve/inxhinierëve;

f) Dokumenti i pronësisë së tokës:

- Certifikata e pronësisë, harta treguese dhe kartela e rifreskuar e pasurisë së paluajtshme (kartela duhet të jetë lëshuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit);

- Vërtetimi i pronësisë shoqëruar me hartën treguese lëshuar nga ASHK-ja (në zonat ku azhurnimi nuk ka përfunduar ende ose është në proces);

- Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, që konfirmohet nga ASHK-ja, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale.

Nëse AMTP-ja nuk konfirmohet nga ASHK-ja, AZHBR-ja kërkon konfirmim zyrtar të këtij dokumenti me sipërfaqen totale, sipërfaqen e parcelave, skicën/plan-vendosjen nga njësi administrative/bashkia përkatëse.

Në rastin e dorëzimit të AMTP-së duhet të dorëzohet certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991 shoqëruar me formularin tip të dakordësisë së anëtarëve të familjes bujqësore, sipas aneksit 12. Marrëveshja duhet të jetë e firmosur nga të gjithë anëtarët sipas gjendjes aktuale. Nëse ka ndryshime midis gjendjes së certifikatës së 1.8.1991 me gjendjen e certifikatës aktuale atëherë marrëveshja duhet të shoqërohet me dokumentacionin plotësues, sipas rastit dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Kur aplikanti merr tokë me qira/huapërdoreje:

- Fotokopje e kontratës së transferimit të të drejtave të përdorimit (kontratë qiraje, huapërdoreje) me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit, me vërtetim noterial shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë;

- Fotokopje e kontratës së qirasë (kontratë/kontratë tip), të lidhur me strukturat publike me një kohëzgjatje minimale të paktën 5 vjet pas datës së aplikimit shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë përkatës sipas kontratës.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Sipas llojit të investimit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularin e kërkesës për pagesë sipas aneksit 13;

b) Faturë/faturat tatimore, shoqëruar me specifikimet teknike të elementeve përkatës dhe vlerën e elementeve përbërëse sipas kontratës;

c) Situacionin e punimeve të kryera (për ndërtim);

ç) Akt zhdoganimit për mallrat/pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementeve përbërëse;

d) Transaksionin bankar, dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi;

dh) Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;

- e) Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë;
- ë) Konfirmim ose kopje të vërtetimit nga sistemi RUDA, që tregon numrin e regjistrimit/matrikullimit e kafshëve në emër të aplikantit;
- f) Regjistrin e plotësuar/përditësuar të fermës.

Masa 11. Për ndërtimin/rikonstruksionin e staneve dhe/ose pajisjeve për përmirësimin e kushteve. Masa e përfitimit të jetë në 70 (shtatëdhjetë)%, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë për subjekt.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesi të mundshëm: Fermer individual, subjekt me status fizik/juridik, SHBB;

a) Janë të pranueshme investimet për ndërtimin/rikonstruksionin e staneve për bagëtitë (dele, dhi dhe/ose gjedh hergjele) në kullota natyrore, si edhe pajisje për krijimin e kushteve të nevojshme për blegtorët dhe aktivitetin blegtoral;

b) Stanet të ndërtohen brenda ose në afërsi të drejtpërdrejtë të kullotës së përdorur nga përfituesi;

c) Të jenë të lidhura funksionalisht me aktivitetin e kullotjes dhe të mos përdoren për qëllime rezidenciale të përhershme;

ç) Distanca nga vendqëndrimi i përhershëm i fermës blegtorale dhe kullotës ku kryhet investimi për stanin të jetë jo më pak se 3 km;

d) Në rastin e punimeve të ndërtimit, të ketë lejen e ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi, dokument i cili mund të dorëzohet deri para lidhjes së kontratës;

dh) Toka që do të përdoret për investimet të jetë në pronësi dhe/ose me qira/huapërdorje për të paktën 3 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit;

e) Janë të pranueshme investimet, të cilat parashikojnë ndërtimin/rikonstruksionin e staneve për jo më pak se 150 krerë të imëta;

ë) Në momentin e kërkesës për pagesë, subjekti duhet të ketë përfunduar investimin, si dhe të ketë prezent në objekt/zotërojnë numrin e krerëve, sipas projektit të propozuar të investimit, të regjistruar në regjistrin RUDA;

f) Investimet duhet të jenë në përputhje me projekt idenë e paraqitur në aneksin 14;

Investimi i propozuar duhet të respektojë sipërfaqen maksimale prej jo më shumë se 50/m², të përcaktuar në funksion të organizimit dhe funksionalitetit të investimit;

g) Aplikanti, me status person fizik/juridik, duhet të jetë i regjistruar për fushën e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe me status aktiv;

gj) Mallrat, sistemet/pajisjet duhet të jenë të reja;

h) Investimi për të cilin kërkohet mbështetje nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës;

i) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR-së/MBZHR-së dhe tatimeve;

j) Aplikanti nuk duhet të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë, sipas përcaktimeve të pikës 13, kreu III të këtij udhëzimi.

Investime të pranueshme:

a) Ndërtimi/rikonstruksionin i ambienteve akomoduese të blegtorit sipas aneksit 14;

b) Ndërtimin/rikonstruksionin e vathës për bagëtitë, i cili mund të përfshijë edhe mbulimin;

c) Mallra dhe pajisje për ambientin akomodues, si krevate (jo më shumë se 4), sistem filtrimi uji, panele fotovoltaike me kapacitet jo më shumë se 4 kw, një frigorifer, një set tavolinë e 4 karrige;

ç) Rrethimin e ambientit akomodues;

d) Ndërtimi/rikonstruksionin i ambientit teknik jo më shumë se 15 m², bashkë me pajisjet e nevojshme për mjeljen dhe ruajtjen e qumështit, si: bidona plastikë ose inoks ushqimor, tanker ftohës, sistem mjeljeje;

dh) Struktura të tjera të lehta, të domosdoshme për funksionimin minimal të stanit, si strehë për ruajtjen e ushqimit, depozita uji, platforma të lehta, gardhe, porta, hijezues dhe pajisje baze energjie nga burime të rinovueshme.

ii. Kriteret konkurruese:

- Kualifikimi i aplikantit në fushën e investimit 60 pikë
- Investime në energji të rinovueshme 20 pikë
- Numri i krerëve 20 pikë

TOTALI 100 pikë

Kualifikimi i aplikantit në fushën e investimit, i dokumentuar me:

- Diplomë e nivelit *Bachelor* në njërin nga fakultetet e Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe të Fakultetit të Bujqësisë të Universitetit të Korçës;
- Diplomë e shkollës së mesme me profil bujqësor/blegtoral;
- Certifikata pjesëmarrjeje në kurse/trajnime me jo më pak se 50 orë në fushën e bujqësisë në 3 vjetët e fundit.

Numri i krerëve

Vlerësimin maksimal 20 pikë e fiton subjekti, i cili ka numrin më të madh të krerëve (500 krerë).

Aplikimet me numrin më të vogël llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$X = \text{Numri i krerëve sipas aplikimit} \times 20/500 \text{ lekë.}$

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- a) Formulari i aplikimit sipas aneksit 11;
- b) Dokumentin e regjistrimit në QKB, që vërteton statusin e aplikantit (subjekt me status fizik, juridik/SHBB), nëse nuk gjenerohet nga sistemi;
- c) Dëshminë e penalitetit për aplikantët (fermer individual, person fizik dhe aksionarët për aplikantët, si person juridik/SHBB), sipas përcaktimeve të pikës 13, kreu III të këtij udhëzimi; ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të aplikimit;
 - ç) 1 ofertë origjinale, shoqëruar me datë, firmë, vlefshmërinë e ofertës, e firmosur dhe vulosur të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) të subjektit ofertues; nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë, sipas kriterëve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të realizojë; ofertuesi/t nuk duhet të jetë/jenë në konflikt interesi me njëri-tjetrin dhe me aplikantin;
- d) Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet;
- dh) Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të aplikimit;
- e) Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e miratimit të njoftimit të punimeve/lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi; ky dokument mund të dorëzohet deri para lidhjes së kontratës;
- ë) Plan-vendosje e strukturës së projektit/leja zhvillimore, preventivi nga personi i licencuar, si dhe i gjeneruar sipas “Hartim preventivi nga manuali i çmimeve në ndërtim” nga *e-Albania*, projekti konstruktiv dhe projekti arkitekturor, për investimet në ndërtim; dokumentacioni duhet të shoqërohet me licencat përkatëse të arkitektëve/inxhinierëve; foto të vendndodhjes së investimit dhe kur kërkohet, koordinata orientuese;
- f) Dokumenti i pronësisë së tokës;

- Certifikata e pronësisë, harta treguese dhe kartela e rifreskuar e pasurisë së paluajtshme (kartela duhet të jetë lëshuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit);
- Vërtetimi i pronësisë shoqëruar me hartën treguese lëshuar nga ASHK-ja (në zonat ku azhurnimi nuk ka përfunduar ende ose është në proces);

- Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, që konfirmohet nga ASHK-ja, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale.

Nëse AMTP-ja nuk konfirmohet nga ASHK-ja, AZHBR-ja kërkon konfirmim zyrtar të këtij dokumenti me sipërfaqen totale, sipërfaqen e parcelave, skicën/plan-vendosjen nga njësia administrative/bashkia përkatëse.

Në rastin e dorëzimit të AMTP-së duhet të dorëzohet certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991 shoqëruar me formularin tip të dakordësisë së anëtarëve të familjes bujqësore, sipas aneksit 9. Marrëveshja duhet të jetë e firmosur nga të gjithë anëtarët sipas gjendjes aktuale. Nëse ka ndryshime midis gjendjes së certifikatës së 1.8.1991 me gjendjen e certifikatës aktuale atëherë marrëveshja duhet të shoqërohet me dokumentacionin plotësues sipas rastit dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Kur aplikanti merr tokë me qira/huapërdoreje:

- Fotokopje e kontratës së transferimit të të drejtave të përdorimit (kontratë qiraje, huapërdorje) me një kohëzgjatje minimale të paktën 3 vjet pas datës së aplikimit, me vërtetim noterial shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë;

- Fotokopje e kontratës së qirasë (kontratë/kontratë tip) të lidhur me strukturat publike me një kohëzgjatje minimale të paktën 3 vjet pas datës së aplikimit shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë përkatës sipas kontratës.

v. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Sipas llojit të investimit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Formularin e kërkesës për pagesë sipas aneksit 15;
- b) Faturë/faturat tatimore, shoqëruar me specifikimet teknike të elementeve përkatës dhe vlerën e elementeve përbërëse sipas kontratës;

- c) Situacionin e punimeve të kryera (për ndërtim);

- ç) Akt zhdoganimit për mallrat/pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementeve përbërëse;

- d) Transaksionin bankar dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi;

- dh) Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet; për fermerët individualë, vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;

- e) Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

- ë) Konfirmim ose kopje të vërtetimit nga sistemi RUDA, që tregon numrin e regjistrimit/matrikullimit e kafshëve në emër të aplikantit;

- f) Regjistrin e plotësuar/përditësuar të fermës.

Masa 12. Për pajisje, makineri dhe mjete bujqësore për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në ferma bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 50 (pesëdhjetë)%, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt dhe jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfitues të mundshëm: Fermer individual, subjekt me status fizik/juridik, SHBB:

a) Aplikantët kryejnë aktivitet bujqësor në ferma me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 0.5 (zero pikë pesë) ha tokë bujqësore/në ferma blegtorale me jo më pak se 5 (pesë) lopë/mëshqerra/jo më pak se 50 (pesëdhjetë) të imëta/jo më pak se 5 (pesë) dosa/paradosa dhe jo më pak se 5 000 (pesë mijë) shpendë. Sipërfaqja e tokës dhe numri i krerëve të jenë brenda një bashkie;

b) Aplikimet me shpenzime të pranueshme nën vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe me vlerë financimi të kërkuar nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë refuzohen;

c) Toka të jetë në pronësi dhe/ose me qira/huapërdorje për të paktën 3 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit;

ç) Mallrat, makineritë/pajisjet/veglat duhet të jenë të reja;

d) Investimi (blerjet) për të cilat kërkohet mbështetje nuk duhet të jenë para lidhjes së kontratës;

dh) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR-së/MBZHR-së/tatimeve;

e) Aplikanti nuk duhet të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë, sipas përcaktimeve të pikës 14, kreu III të këtij udhëzimi.

Shpenzime të pranueshme

1. Sektori i gjedhit dhe të imëtave:

- Pajisje mjeljeje portative ose fikse;
- Sistem mjeljeje me 1–4 poste;
- Bidona plastikë ose inoks ushqimor për qumësht;
- Tanker ftohës për qumësht me kapacitet të vogël dhe të mesëm;
- Tanker ftohës për qumësht me kapacitete të ndryshme për transport me makina lëvizëse;
- Peshore për kafshë;
- Ushqyes dhe ujëpirëse;
- Gardhe elektrike ose të lëvizshme;
- Rrjeta rrethuese, shtylla, porta dhe aksesore montimi;
- Depozita uji, pompa uji, tuba dhe pajisje shpërndarjeje;
- Gjenerator portativ ose sistem fotovoltai i vogël me aksesore;
- Kontejnerë ushqimorë, kosha, lugje, karroca dore dhe mjete të thjeshta transporti brenda fermës;

- Mjete për pastrim, dezinfektim dhe higjienë të objektit.

2. Sektori i bletarisë:

- Zgjoje (koshere);
- Ndarëse, ushqyes, bazamente dhe aksesore për zgjojet;
- Veshje mbrojtëse dhe maska;
- Nxjerrëse mjalti;
- Enë inoksi për mjaltë, sitë dhe filtra;
- Tavolinë për zhvulosjen e hojeve të mjaltit, thikë elektrike ose mjete të ngjashme;
- Struktura të lehta të çmontueshme për akomodim sezonal të bletarit dhe vjeljen e mjaltit;
- Depozita ruajtjeje dhe pajisje paketimi në nivel ferme.

3. Sektori i serrave, perimeve dhe hortikulturës:

- Sisteme ujitjeje me pika, pompa, filtra, ferti-irrigim bazë;
- Sisteme ventilimi, hijezimi, mjegullimi ose ngrohjeje bazë;
- Tavolina, arka, karroca pune dhe pajisje të thjeshta për vjelje dhe trajtim;
- Spërkatëse manuale ose me motor;
- Motokultivatorë të lehtë dhe freza.

4. Pemëtaria, vreshtaria dhe ullishtaria:

- Spërkatëse shpine, me motor ose e tërheqshme;
- Gërshërë krasitjeje, sharra, motosharra të lehta;
- Shkallë alumini, karroca mbledhjeje, arka dhe bins të vegjël;
- Pompa uji, tuba, sisteme pikimi dhe aksesore ujitjeje;
- Shtylla mbështetëse, tela të sistemit mbështetës;
- Shkundëse ulliri; cisterna për mbajtjen e vajit të ullirit.

5. Mekanizimi i lehtë dhe pajisjet universale të fermës (bujqësore dhe blegtorale):

- Traktorë të vegjël;
- Motokultivatorë;
- Freza, plugje të lehta, korrëse, mbledhëse bari, kultivatorë dhe nivelues të vegjël;
- Rimorkio të vogla për motokultivator;
- Pompa motorike, gjeneratorë portativë;
- Kompresorë, saldatriçe dhe vegla pune të domosdoshme për mirëmbajtje;
- Karroca dore, paletë dore, rafte metalike dhe pajisje ruajtjeje.

6. Pajisje digjitale dhe për bujqësi precize:

- Sensorë bazë për lagështi, temperaturë dhe klimë;
- Stacione të thjeshta meteorologjike;
- Kamera monitorimi dhe sisteme bazë alarmi;
- Pajisje GPS dhe mjete të tjera digjitale që lidhen drejtpërdrejt me procesin prodhues.

ii. Kriteret konkurruese:

- Sipërfaqja/numri i krerëve të kafshëve	60 pikë
- Subjekt me status SHBB	15 pikë
- Mosha e aplikantit	25 pikë
TOTALI 100 pikë	

Njëri-tjetrin

Sipërfaqja e mbjellë/numri i krerëve të kafshëve

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen e mbjellë e fiton aplikimi me sipërfaqen/krerët maksimale (5 ha, 10 krerë lopë/mëshqerra, 100 krerë të imëta dhe 10 dosa/paradosa, 10 mijë shpendë), të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këto shifra.

Aplikimet me sipërfaqe më të vogla se 5 ha/numër krerësh më të vogël llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$X = \text{Sipërfaqja/krerët për të cilën aplikon (sipërfaqja në dynym/krerët)} \cdot 60 / \text{sipërfaqen/krerët maksimal (5 ha, 10 krerë lopë/gjedh, 100 krerë të imëta dhe 10 dosa, 10 mijë shpendë)}.$

Subjekt me status SHBB (15 pikë):

Marrin 15 pikë subjektet me status SHBB.

Mosha e aplikantit (25 pikë):

Marrin 25 pikë aplikantët të cilët në datën e aplikimit janë nën 40 vjeç. Për personat juridikë pikëzimi do të bëhet duke llogaritur moshën e aksionarëve.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR:

- a) Formulari i aplikimit sipas aneksit 11;
- b) Dokumentin e regjistrimit në QKB, që vërteton statusin e aplikantët (subjekt me status fizik, juridik/SHBB), nëse nuk gjenerohet nga sistemi;
- c) Dëshminë e penalitetit për aplikantët (fermer individual, person fizik dhe aksionarët për aplikantët si person juridik/SHBB), sipas përcaktimeve të pikës 14, kreu III, të këtij udhëzimi; ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të aplikimit;

ç) 1 ofertë origjinale shoqëruar me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) dhe vlefshmërinë e ofertës; nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë sipas kriterëve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të ofrojë. Ofertuesi/t nuk duhet të jetë/jenë në konflikt interesi me njëri-tjetrin dhe me aplikantin.

d) Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet;

dh) Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të aplikimit;

e) Regjistri RUDA për feramat me drejtim blegtoral;

ë) Dokumenti i pronësisë së tokës për feramat bujqësore:

- Certifikata e pronësisë, harta treguese dhe kartela e rifreskuar e pasurisë së paluajtshme (kartela duhet të jetë lëshuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit);

- Vërtetimi i pronësisë shoqëruar me hartën treguese lëshuar nga ASHK-ja (në zonat ku azhurnimi nuk ka përfunduar ende ose është në proces);

- Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, që konfirmohet nga ASHK-ja, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale.

Nëse AMTP-ja nuk konfirmohet nga ASHK-ja, AZHBR-ja kërkon konfirmim zyrtar të këtij dokumenti me sipërfaqen totale, sipërfaqen e parcelave, skicën/plan-vendosjen nga njësia administrative/bashkia përkatëse.

Në rastin e dorëzimit të AMTP-së duhet të dorëzohet certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991, shoqëruar me formularin tip të dakordësisë së anëtarëve të familjes bujqësore, sipas aneksit 9. Marrëveshja duhet të jetë e firmosur nga të gjithë anëtarët sipas gjendjes aktuale; nëse ka ndryshime midis gjendjes së certifikatës së 1.8.1991 me gjendjen e certifikatës aktuale, atëherë marrëveshja duhet të shoqërohet me dokumentacionin plotësues sipas rastit dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Kur aplikanti merr tokë me qira/huapërdorjeje:

- Fotokopje e kontratës së transferimit të të drejtave të përdorimit (kontratë qiraje, huapërdorje) me një kohëzgjatje minimale të paktën 3 vjet pas datës së aplikimit, me vërtetim noterial shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë;

- Fotokopje e kontratës së qirasë (kontratë/kontratë tip), të lidhur me strukturat publike, me një kohëzgjatje minimale të paktën 3 vjet pas datës së aplikimit, shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë përkatës sipas kontratës.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Sipas llojit të investimit (blerjes), aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim.

Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularin e kërkesës për pagesë sipas aneksit 16;

b) Faturën/faturat tatimore, shoqëruar me specifikimet teknike të traktorit/makinerve/pajisjeve dhe vlerën sipas kontratës;

c) Lejen e qarkullimit për traktorët;

ç) Akt zhdoganimit për mallra/makineri/pajisje, që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementeve përbërëse;

d) Transaksionin bankar dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi;

dh) Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet;

e) Për fermerët individualë, vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;

ë) Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë;

f) Regjistrin e plotësuar/përditësuar të fermës.

XI. PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES, VERIFIKIMIT DHE EKZEKUTIMIT TË PAGESAVE PËR MASAT NR. 10–12

1. AZHBR-ja, nëpërmjet Zyrës së Protokollit, pranon dosjet e aplikimit me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimit. Një kopje e këtij formulari i jepet aplikantit.

2. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas masës mbështetëse.

3. Në rastin kur aplikanti gjendet në një nga situatat e përmendura si më poshtë, aplikimi do të refuzohet menjëherë.

Mangësi skualifikuese në procesin e aplikimit, janë si më poshtë:

- Mungesa e formularit të aplikimit sipas Aneksit përkatës;
- Mungesa e ofertës;
- Ofertuesit janë në konflikt interesi me aplikantin;
- Paraqitja e dokumenteve/deklarimeve të rreme.

4. Aplikantët informohen zyrtarisht lidhur me mangësitë në dokumentacion të administruar në dosjen e aplikimit, dhe u lihet afat 20 ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit për plotësimin e tyre; çdo dokumentacion shtesë i dorëzuar, por i pakërkuar nga AZHBR-ja, nuk do të merret në konsideratë në vlerësimin e aplikimit.

5. Dorëzimi i dokumenteve përtej afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi (me përjashtim të dokumentit të lejes së ndërtimit/miratimit e njoftimit të punimeve).

6. Mbas plotësimit të dosjes, bëhet vlerësimi për përputhshmërinë e kriterëve për çdo masë mbështetëse.

7. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Për aplikimet me pikë të barabarta, zbatohet parimi: “Kush vjen i pari renditet i pari”.

8. Për aplikantët e renditur mbi vijën, referuar tavaneve të financimit bëhet ***kontrolli paraprak në terren***, dhe nëse rezultojnë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, AZHBR-ja lidh kontratën përkatëse dhe shpall ***listën e fituesve***.

9. Në kontratën që AZHBR-ja do të nënshkruajë me aplikantin fitues, duhet të përcaktohen qartë penalitetet, në rastet kur përfituesi i fondeve të masave mbështetëse nuk pranon të kontrollohet prej inspektorëve të AZHBR-së.

10. Grupi i kontrollit në terren bën verifikimin në vend të aplikimit, duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij ose të përfaqësuesit ligjor të pajisur me prokurë.

11. Grupi i kontrollit, në prani të aplikantit ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson raportin e verifikimit, sipas masës përkatëse. Raporti i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

12. Aplikimi, kontrolli administrativ, verifikimi në terren, arsyeshmëria e çmimeve, autorizimi, ekzekutimi i pagesës dhe monitorimi i aplikimeve për masat e investimeve nr. 10–12 përshkruhen në “Manualin e procedurave për implementimin e masave të investimeve viti 2026”, të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AZHBR-së.

13. Projektet për masat e investimeve, me vlerë financimi mbi 500 000 lekë, monitorohen 5 (pesë) vjet nga pagesa e fundit e AZHBR-së.

14. AZHBR-ja, gjatë procesit të aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe ekzekutimit të pagesave për çështje që nuk kanë një rregullim të posaçëm në vendimmarrje, zbaton parimet:

- Trajtim të barabartë të aplikimeve; dhe
- Parimin e proporcionalitetit.

Lëvizja e vizës së financimit dhe rialokimi i fondeve

15. Nëse nga “Kontrolli administrativ” dhe “Kontrolli në terren” rezultojnë aplikime të refuzuara nga AZHBR-ja për mosplotësim të kriterëve të përfitimit apo moskryerje të investimit, bëhet plotësimi i fondit më fitues të tjerë të masës nga aplikantët e radhës.

16. Për projektet e skualifikuara nga kontrollat administrative dhe në terren, AZHBR-ja njofton aplikantët, duke bashkëngjitur edhe arsyen e skualifikimit.

XII. PAGESAT PËR VLERAT E PALIKUIDUARA

1. Për fondin 159 954 159 (*njëqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë*) lekë, për pagesën e vlerës së palikuiduar për kontratat, për të cilat nuk është autorizuar pagesa finale në masat e mbështetjes për investime nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në zbatim të pikave 2.3 dhe 3/2, të vendimit nr. 130, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2024”, të ndryshuar, ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Aprovimit të Pagesës (KVAP) me urdhër të drejtorit të AZHBR-së, me përbërje 5 përfaqësues nga AZHBR-ja, ku njëri prej të cilëve caktohet kryetar.

Për aplikimet që nuk është marrë certifikata e përdorimit (leja e shfrytëzimit), në rastet kur leja e ndërtimit përfshin grup ndërtimesh, AZHBR-ja mund të procedojë me pagesat, kur aplikanti dorëzon akt kontrollin përfundimtar të lëshuar nga bashkia përkatëse, i cili vërteton se objekti është ndërtuar sipas projektit dhe plan vendosjes së miratuar.

Certifikata e përdorimit duhet të depozitohet në AZHBR nga aplikanti, brenda afatit të monitorimit të investimit, në të kundërt AZHBR-ja ndjek procedurat për kthimin e grantit të përfituar.

2. Për fondin 9 662 269 (nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, për pagesën e vlerës së palikuiduar për subjektet përfituese, në zbatim të vendimit nr. 150, datë 6.3.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2025”, të ndryshuar, për aplikimet e masave direkte 2025, AZHBR-ja procedon për financimin e tyre, sipas një procedurë të brendshme administrative, të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AZHBR-së, për shqyrtimin, vlerësimin dhe ekzekutimin e pagesave ndaj subjekteve përfituese.

XIII. KONTROLI PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT DHE ÇËSHTJE TË TJERA

1. AZHBR-ja është përgjegjëse për zbatimin, auditimin dhe likuidimin financiar të përfituesve, sipas masave të mbështetjes dhe kriterëve të përfitueshmërisë.

2. AZHBR-ja gëzon të drejtën për të kërkuar çdo informacion/dokumentacion shtesë, në rast se e gjykon të arsyeshme, brenda kriterëve dhe procedurave të miratuara.

3. Për faturat në valutë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e çeljes së thirrjes për aplikim.

4. Dokumentet e dorëzuara bëhen pronë e AZHBR-së, sipas përcaktimeve nga ligji për ruajtjen e dokumentacionit, dhe nuk i kthehen aplikantit.

5. MBZHR-ja dhe AZHBR-ja hartojnë dhe zbatojnë një plan trajnimi me stafin që do të përfshihet në procesin e implementimit të masave mbështetëse, për të cilat aplikimi bëhet *online*.

6. MBZHR-ja dhe AZHBR-ja hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me grupet e interesit për masat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfituar mbështetje financiare nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

7. Për kontrollin e përmbushjes nga aplikantët të kushtëzimeve (SMR dhe GAEC) në masat mbështetëse përkatëse të përcaktuara në këtë udhëzim, AZHBR-ja bashkëpunon dhe koordinon punën me AREB-të dhe AKVMB-të.

8. Alokimi i fondit sipas masave mbështetëse bëhet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas propozimit të AZHBR-së.

9. Në rastet kur numri i aplikuesve të një mase nuk plotëson tavanin e financimit për masën përkatëse, rialokimi i fondeve në masat e tjera bëhet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me propozim të AZHBR-së.

10. Për masat mbështetëse nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8 dhe nr. 9, në rastet kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse, sipas listës përfundimtare të përfituesve, vlera e financimit që përfitohet për njësi (krerë, zgjua apo ha), si dhe në total për subjekt, reduktohet në përputhje me këtë fond. Ky reduktim nuk zbatohet për aplikantët me status “SHBB”.

11. Për Masat nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 9, bazuar në vlerësimin e riskut dhe rezultatet e verifikimeve në terren, kontrolli mund të përfshijë deri në 100% të numrit të aplikantëve përfitues.

12. Formularët/raportet e verifikimit në terren, sipas masave mbështetëse, përgatiten nga AZHBR-ja, në përputhje dhe në zbatim të këtij udhëzimi.

13. Aplikuesit, të cilët skualifikohen gjatë implementimit të masave mbështetëse paraqesin ankesën e tyre brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit pranë AZHBR-së.

14. AZHBR-ja brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës bën verifikimin përkatës dhe i jep përgjigje ankimuesit.

15. Mbështetja financiare llogaritet mbi vlerën e faturës tatimore, përjashtuar vlerën e TVSH-së.

16. Në momentin e aplikimit, aplikanti pranon që të dhënat e tij personale të përdoren vetëm për qëllim të këtij aplikimi. AZHBR-ja garanton mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve sipas ligjeve në fuqi.

17. Në rast të konstatimit të “kundërvajtjeve administrative”, nga ana e përfituesit, në drejtim të tjetërsimit të qëllimit, për të cilën janë marrë fondet apo mosmbajtjes së dokumentacionit të përdorur për përfitimin e fondeve për një periudhë 5-vjeçare, AZHBR-ja propozon sanksione të përcaktuara në nenin 39, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

18. Për menaxhimin e fondeve, AZHBR-ja raporton në mënyrë periodike në MBZHR, e cila raporton çdo katërmujor në MF për ecurinë e realizimit të programit të mbështetjes financiare.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Ministria e Financave.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

MINISTËR I FINANCEVE

ANEKSI 1
LISTA E ZYRAVE TË APLIKIMEVE

Nr.	Qarku	Zyrat e aplikimit	Poste pune/numër specialistësh për aplikime
1	Berat	AGROPIKA Berat	3
2		Zyra e Bujqësisë Berat	2
3		Zyra e Bujqësisë Skrapar	1
4		Zyra e Bujqësisë Kuçovë	1
5	Korçë	AGROPIKA Korçë	4
6		AGROPIKA Pogradec	2
7		Zyra e Bujqësisë Devoll	2
8		Zyra e Bujqësisë Pogradec	2
9		Zyra e Bujqësisë Kolonjë	1
10		Zyra e Bujqësisë Korçë	5
11	Elbasan	AGROPIKA Elbasan	2
12		AGROPIKA Librazhd	1
13		Zyra e Bujqësisë Elbasan	3
14		Zyra e Bujqësisë Peqin	1
15		Zyra e Bujqësisë Librazhd	1
16		Zyra e Bujqësisë Përrenjas	1
17		Zyra e Bujqësisë Gramsh	1
18	Dibër	AGROPIKA Dibër	2
19		AGROPIKA Mat	2
20		Zyra e Bujqësisë Dibër	1
21		Zyra e Bujqësisë Bulqizë	2
22		Zyra e Bujqësisë Burrel	1
23		Zyra e Bujqësisë Klos	1
24	Durrës	AGROPIKA Rashbull, Durrës	3
25		Zyra e Bujqësisë Durrës	1
26		Zyra e Bujqësisë Manzë	1
27		Zyra e Bujqësisë Gjipalaj	1
28		Zyra e Bujqësisë Fushë-Krujë	1
29		Zyra e Bujqësisë Sukth	1
30	Tiranë	AGROPIKA Tiranë	3
31		AGROPIKA Kavajë	3
32		Zyra e Bujqësisë Tiranë	2
33		Zyra e Bujqësisë Kavajë	2
34	Fier	AGROPIKA Fier	4
35		AGROPIKA Lushnjë	4
36		Zyra e Bujqësisë Fier	5
37		Zyra e Bujqësisë Mallakastër	1
38		Zyra e Bujqësisë Lushnjë	8
39	Gjirokastrë	AGROPIKA Gjirokastrë	3
40		AGROPIKA Përmet	2
41		Zyra e Bujqësisë Gjirokastrë	4
42		Zyra e Bujqësisë Tepelenë	1
43		Zyra e Bujqësisë Përmet	2
44	Vlorë	AGROPIKA Vlorë	4
45		AGROPIKA Sarandë	2
46		Zyra e Bujqësisë Vlorë	1

47		Zyra e Bujqësisë Sarandë	1
48		Zyra e Bujqësisë Delvinë	1
49	Kukës	AGROPIKA Kukës	2
50		Zyra e Bujqësisë Kukës	1
51		Zyra e Bujqësisë Has	1
52		Zyra e Bujqësisë Tropojë	1
53	Lezhë	AGROPIKA Lezhë	3
54		Zyra e Bujqësisë Lezhë	1
55		Zyra e Bujqësisë Mirditë	1
56		Zyra e Bujqësisë Kurbin	1
57	Shkodër	AGROPIKA Shkodër	3
58		AGROPIKA Pukë	1
59		Zyra e Bujqësisë Shkodër	7
60		Zyra e Bujqësisë Malësi e Madhe	1
61		Zyra e Bujqësisë Dajç	1
62	TOTAL		127

ANEKSI 2 KUSHTËZIMET PËR MASËN 1

Pagesa në vlerën deri në 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë/krerë, për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë dhe/ose mëshqerra.

Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB)”.

a) Kufizime në përdorimin e substancave që kanë veprim hormonal ose tireostatik dhe beta-agonistëve në kafshët e fermës (SMR 6)

Ky kushtëzim¹ synon të ndalojë përdorimin e paligjshëm të substancave me qëllim parandalimin e mbetjeve që këto substanca lënë në mish dhe ushqimeve të tjera që të hyjnë në zinxhirin ushqimor të njerëzve ose të kafshëve.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Trajtimet e kafshëve me hormone që janë të ndaluara;
- Të gjitha të dhënat mjekësore veterinare që lidhen me trajtimin e kafshëve duhet të mbahen në: “Regjistrin përkatës të fermës për trajtimet veterinare” dhe ta vërë atë në dispozicion të autoritetit kompetent gjatë kontrollit;
- Administrimi i një substance të kufizuar te një kafshë ferme është i ndaluar, përveç nëse administrohet në përputhje me ndonjë përjashtim të lejuar;
- Është e ndaluar të hidhen në treg ose të dërgohen për therje kafshët të cilave u është administruar një substancë e kufizuar, përveç nëse kjo është dhënë në përputhje me përjashtimet e lejuara;
- Është e ndaluar të shitet mishi ose çdo produkt tjetër shtazor, i nxjerrë nga një kafshë, së cilës i është administruar një substancë e kufizuar, përveç nëse është dhënë në përputhje me përjashtimet e lejuara.
- Krite të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

b) Mirëqenia e kafshëve (SMR 11)

¹ Referuar urdhrit nr. 357, datë 22.12.2011, “Për kushtet e tregtimit dhe të përdorimit në kafshë të disa lëndëve me veprim hormonal, tireostatik dhe beta-agonist”.

Ky kushtëzim² synon mbrojtjen e mirëqenies së çdo lloji kafshe të mbarështuar (për qëllime bujqësore), duke përmbushur standardet minimale për kujdesin dhe mbarështimin e tyre.

Të gjithë fermerët që mbarështojnë kafshë për qëllime bujqësore duhet të përmbushin standardet minimale specifike të mirëqenies.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Liri të mjaftueshme të lëvizjes;
- Kafshët të jenë të matrikulluara dhe të regjistruara në modulën e regjistrin e fermës dhe në modulën e identifikimit individual RUDA³;
- Regjistrin e përditësuar të fermës;
- Procedurat e të ushqyerit të kafshëve, përfshirë sigurimin e ushqimit, ujit dhe substancave të tjera të lejuara;
- Ambientet e mbarështimit, me hapësira në përputhje me rregullat që zbatohen për mirëqenien e kafshëve për mbarështimin në krerë/m²;
- Staf kompetent dhe magazinues të aftë;
- Mbajtjen e të dhënave në librin e mjekimeve (për të paktën tre vjet) të trajtimit mjekësor të dhënë, numrit të vdekjeve etj., i përditësuar dhe i lëshuar nga autoriteti kompetent;
- Ajër i përshtatshëm i ventilluar;
- Ndriçim i përshtatshëm, natyral ose artificial;
- Mjetet e pastrimit dhe dezinfektimit që përdoren në stallë, mënyra e funksionimit të tyre;
- Programet e monitorimit;
- Krite të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës;

c) Mirëqenia e viçave (SMR 9)

Ky kushtëzim⁴ synon mbrojtjen dhe sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së viçave, d.m.th., kafshëve të racës gjedh deri në gjashtë muaj, duke përmbushur standardet minimale për kujdesin dhe mbarështimin e tyre.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Ambientet e mbarështimit;
- Lirisë së lëvizjes;
- Praktikat e duhura të ushqyerjes (ujë dhe kulloshtë të mjaftueshëm);
- Kushtet e higjienës për mbarështimin e kafshëve të reja, për riprodhim/remont;
- Kushtet lidhur me gazrat (amoniak, CO₂, etj.), me ndikim në shëndetin e kafshëve;
- Krite të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

d) Higjiena e Ushqimit dhe e Ushqimit për Kafshë (SMR 5)

² Në zbatim të protokoll-kontrollit (shtojca 1) të urdhrit nr. 651, datë 31.12.2021, "Për miratimin e formateve të protokoll-kontrolleve, që kryhen nga veterineri zyrtar", dhe urdhrit nr. 286, datë 21.9.2012, "Mbi mbrojtjen e kafshëve të mbajtura për qëllime bujqësore".

³ Sipas rregullores nr. 1, datë 7.5.2000, "Mbi sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të kafshëve blegtorale", urdhrit nr. 459 datë 2.10.2006, "Për miratimin e rregullores 'Mbi sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të bagëtive të imëta'", dhe urdhrit nr. 407, datë 19.9.2008, "Për miratimin e rregullores 'Mbi implementimin e rregullores nr. 1, datë 7.5.2000, në lidhje me matrikujt, pasaportën dhe regjistrin e fermës'".

⁴ Referuar urdhrit nr. 329, datë 24.6.2014, "Mbi normat minimale për mbrojtjen e viçave", si edhe urdhrit nr. 651, datë 31.12.2021, "Për miratimin e formateve të protokoll-kontrolleve, që kryhen nga veterineri zyrtar", nëpërmjet kontrollit "Për plotësimin e kushteve sanitaro-veterinare dhe mirëqenies së kafshëve në stabilimentet/fermat që mbarështojnë kafshë të gjalla të llojit gjedhë (shtojca 1).

Ky kushtëzim⁵ synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të shëndetit publik, si dhe shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe përfshin të gjithë aplikantët që prodhojnë ushqim ose ushqim për kafshë nga bimët dhe që rrisin kafshë për ushqim, ose që prodhojnë produkte me origjinë shtazore, duke përfshirë qumështin dhe vezët.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Prodhimin dhe ruajtjen e sigurt të ushqimit;
- Të dhënat e gjurmueshmërisë mbahen për të paktën 3 vjet;
- Bulmeti/depoja e mjeljes, pajisjet dhe strehimi i lopëve mbahen të pastra dhe në gjendje të mirë, dhe që bulmeti është i izoluar nga burimet e kontaminimit;
- Respektimin e praktikave të higjienës gjatë mjeljes;
- Parazitët në fermë janë nën kontroll të mjaftueshëm;
- Respektimin e periudhave të tërheqjes për produktet e autorizuar;
- Kriteria të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

ANEKSI 3 KUSHTËZIMET PËR MASËN 2

Pagesa në vlerën deri në 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) krerë dele dhe/ose dhi.

Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.

a) Kufizime në përdorimin e substancave që kanë veprim hormonal ose tireostatik dhe beta-agonistëve në kafshët e fermës (SMR 6)

Ky kushtëzim⁶ synon të ndalojë përdorimin e paligjshëm të substancave me qëllim parandalimin e mbetjeve që këto substanca lënë në mish dhe ushqimeve të tjera, që të hyjnë në zinxhirin ushqimor të njerëzve ose të kafshëve.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Trajtimet e kafshëve me hormone që janë të ndaluara;
- Të gjitha të dhënat mjekësore veterinare që lidhen me trajtimin e kafshëve duhet të mbahen në: “Regjistrin përkatës të fermës për trajtimet veterinare” dhe ta vërë atë në dispozicion të autoritetit kompetent gjatë kontrollit;
- Administrimi i një substance të kufizuar te një kafshë ferme është i ndaluar, përveç nëse administrohet në përputhje me ndonjë përjashtim të lejuar;
- Është e ndaluar të hidhen në treg ose të dërgohen për therje kafshët të cilave u është administruar një substancë e kufizuar, përveç nëse kjo është dhënë në përputhje me përjashtimet e lejuara;
- Është e ndaluar të shitet mishi ose çdo produkt tjetër shtazor, i nxjerrë nga një kafshë, së cilës i është administruar një substancë e kufizuar, përveç nëse është dhënë në përputhje me përjashtimet e lejuara;

⁵ Bazuar në nenet 23 dhe 25 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar; udhëzimin nr. 22, datë 25.11.2010, “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”; udhëzimin nr. 5, datë 25.3.2011, “Për kërkesat specifike të higjienës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi”, i ndryshuar.

⁶ Bazuar në kërkesat e urdhrit nr. 357, datë 22.12.2011, “Për kushtet e tregtimit dhe përdorimit në kafshë të disa lëndëve me veprim hormonal, tireostatik dhe beta-agonist”, dhe, në rastet e trajtimeve të lejuara sipas legjislacionit në fuqi.

- Kritere të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

b) Mirëqenia e kafshëve (SMR 11)

Ky kushtëzim⁷ synon mbrojtjen e mirëqenies së çdo lloji kafshe të mbarështuar (për qëllime bujqësore), duke përmblusur standardet minimale për kujdesin dhe mbarështimin e tyre.

Të gjithë fermerët që mbarështojnë kafshë për qëllime bujqësore duhet të përmblushin standardet minimale specifike të mirëqenies përkatëse.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Liri të mjaftueshme të lëvizjes;
- Kafshët të jenë të matrikulluara dhe të regjistruara në modulën e regjistrin e fermës dhe në modulën e identifikimit individual RUDA;
- Regjistrin e përditësuar i fermës;
- Procedurat e të ushqyerit të kafshëve, përfshirë sigurimin e ushqimit, ujit dhe substancave të tjera të lejuara;
- Ambientet e mbarështimit, me hapësira në përputhje me rregullat që zbatohen për mirëqenien e kafshëve për mbarështimin në krerë/m²;
- Staf kompetent dhe magazinues të aftë;
- Mbajtjen e të dhënave në librin e mjekimeve (për të paktën tre vjet) të trajtimit mjekësor të dhënë, numrit të vdekjeve etj., i përditësuar dhe i lëshuar nga autoriteti kompetent;
- Ajër i përshtatshëm i ventiluar;
- Ndriçim i përshtatshëm, natyral ose artificial;
- Mjetet e pastrimit dhe dezinfektimit, që përdoren në stallë, mënyra e funksionimit të tyre;
- Programet e monitorimit;
- Kushteve për higjienë dhe mbarështimin e kafshëve të reja, për riprodhim ose remont për m²;
- Kushtet lidhur me gazrat (amoniak, dyoksid karboni etj.), me ndikim në shëndetin e kafshëve;
- Kritere të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

c) Higjiena e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë (SMR 5)

Ky kushtëzim⁸ synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të shëndetit publik, si dhe shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe përfshin të gjithë aplikantët, që prodhojnë ushqim ose ushqim për kafshë nga bimët dhe që rrisin kafshë për ushqim, ose që prodhojnë produkte me origjinë shtazore, duke përfshirë qumështin dhe vezët.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Prodhimin dhe ruajtjen e sigurt të ushqimit;
- Të dhënat e gjurmueshmërisë mbahen për të paktën 3 vjet;
- Bulmeti/depoja e mjeljes, pajisjet dhe strehimi i lopëve mbahen të pastra dhe në gjendje të mirë dhe që bulmeti është i izoluar nga burimet e kontaminimit;
- Respektimin e praktikave të higjienës gjatë mjeljes;
- Parazitët në fermë janë nën kontroll të mjaftueshëm;

⁷ Bazuar në zbatim të urdhrit nr. 286, datë 21.9.2012, "Mbi mbrojtjen e kafshëve të mbajtura për qëllime bujqësore", urdhrit nr. 651, datë 31.12.2021, "Për miratimin e formateve të protokoll kontrolleve që kryhen nga veterineri zyrtar", nëpërmjet Protokollit të Kontrollit, "Për plotësimin e kushteve sanitaro-veterinare dhe mirëqenies së kafshëve në stabilimentet/fermat që mbarështojnë kafshë të gjalla të imëta (shtojca 2).

⁸ Bazuar në nenin 23 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar; udhëzimin nr. 22, datë 25.11.2010, "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor"; në udhëzimin nr. 5, datë 25.3.2011, "Për kërkesat specifike të higjienës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi", të ndryshuar.

- Respektimin e periudhave të tërheqjes për produktet e autorizuar;
- Planimetrinë dhe vendosja e fermës;
- Burimet e ushqimit dhe të ujit;
- Dezinfektimet;
- Mjetet e transportit;
- Personeli;
- Vizitorët;
- Kritere të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

ANEKSI 4 KUSHTËZIMET PËR MASËN 3

Mbarështimi i bletarisë në vlerën deri në 2 000 (dy mijë) lekë për zgjua, për fermer/aplikant me jo më pak se 25 (njëzet e pesë) zgjoje.

Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.

Ky kushtëzim⁹ synon mbrojtjen dhe sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së bletëve, duke përmbushur standardet minimale për kujdesin dhe mbarështimin e tyre. Të gjithë fermerët që mbarështojnë bletë, duhet të përmbushin standardet minimale specifike të mirëqenies përkatëse.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Regjistrimin e parkut, sipas regjistrit të fermës (formulari i regjistrimit).
- Zgjoje të matrikulluara dhe të regjistruara në regjistrin e Shërbimit Veterinar Rajonal, të miratuar.
- Regjistri i lëvizjes së koshereve në fermë i përditësuar;
- Profilaksia është e dokumentuar në librin e mjekimeve të parkut të bletëve;
- Në fermë mbahet libri i mjekimeve, sipas modelit të miratuar;
- PMV-të e përdorura në fermë janë të autorizuar për t'u përdorur;
- Prodhim i sigurt i mjaltit;
- Siguri në gjurmueshmërinë e produktit për subjektet e licencuara;
- Ruajtje dhe trajtim i produktit në mënyrën e duhur;
- Njoftimin e sëmundjeve;
- Nëse është konstatuar vendosja e produkteve të pasigurta në treg.

ANEKSI 5 KUSHTËZIMET PËR MASËN 4

Pagesa për dosa dhe/ose paradosa të matrikulluara në vlerën deri në 7 000 (shtatë mijë) lekë/krerë dosë/paradosë, për fermer/aplikant me jo më pak se 5 (pesë) krerë dosa dhe/ose paradosa.

Për pjesën mbi 100 (njëqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.

⁹ Bazuar në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në ligjin 20/2023, “Për bletarinë”, si dhe në urdhrin nr. 651, datë 31.12.2021, “Për miratimin e formateve të protokoll-kontrolleve, që kryhen nga veterineri zyrtar”, nëpërmjet protokollit të kontrollit “Plotësimin e kushteve, sanitaro-veterinare dhe mirëqenies së kafshëve në stabilimentet (fermat), që mbarështojnë kafshë të gjalla të llojit bletë” (shtojca 5).

a) Kufizime në përdorimin e substancave që kanë veprim hormonal ose tireostatik dhe beta-agonistëve në kafshët e fermës (SMR 6)

Ky kushtëzim¹⁰ synon të ndalojë përdorimin e paligjshëm të substancave, me qëllim parandalimin e mbetjeve, që këto substanca lënë në mish dhe ushqime të tjera që të hyjnë në zinxhirin ushqimor të njerëzve ose të kafshëve.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Trajtimet e kafshëve me hormone që janë të ndaluar;
- Të gjitha të dhënat mjekësore veterinare që lidhen me trajtimin e kafshëve duhet të mbahen në: “Regjistrin përkatës të fermës për trajtimet veterinare”, dhe ta vërë atë në dispozicion të autoritetit kompetent gjatë kontrollit;
- Administrimi i një substance të kufizuar të një kafshë ferme është i ndaluar, përveç nëse administrohet në përputhje me ndonjë përjashtim të lejuar;
- Është e ndaluar të hidhen në treg ose të dërgohen për therje kafshët të cilave u është administruar një substancë e kufizuar, përveç nëse kjo është dhënë në përputhje me përjashtimet e lejuara;
- Është e ndaluar të shitet mishi ose çdo produkt tjetër shtazor, i nxjerrë nga një kafshë, së cilës i është administruar një substancë e kufizuar, përveç nëse është dhënë në përputhje me përjashtimet e lejuara;
- Krite të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

b) Mirëqenia e kafshëve (SMR 11)

Ky kushtëzim¹¹ synon mbrojtjen e mirëqenies së çdo lloji kafshe të mbarështuar (për qëllime bujqësore), duke përmbushur standardet minimale për kujdesin dhe mbarështimin e tyre.

Të gjithë fermerët që mbarështojnë kafshë për qëllime bujqësore duhet të përmbushin standardet minimale specifike të mirëqenies përkatëse.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Liri të mjaftueshme të lëvizjes;
- Kafshët të jenë të matrikulluara dhe të regjistruara në modulën e regjistrin e fermës dhe në modulën e identifikimit individual RUDA¹²;
- Regjistrin e përditësuar të fermës;
- Procedurat e të ushqyerit të kafshëve, përfshirë sigurimin e ushqimit, ujit dhe substancave të tjera të lejuara;
- Ambientet e mbarështimit, me hapësira, në përputhje me rregullat që zbatohen për mirëqenien e kafshëve për mbarështimin në krerë/m²;
- Personel i trajnuar, i kualifikuar dhe magazinues të aftë;
- Dëshmi të prerjes/gjymtimit të papërshtatshëm të bishtit;
- Mbajtjen e të dhënave në librin e mjekimeve (për të paktën tre vjet) të trajtimit mjekësor të dhënë, numrit të vdekjeve etj., i përditësuar dhe i lëshuar nga autoriteti kompetent;

¹⁰ Referuar urdhrit nr. 357, datë 22.12.2011, “Për kushtet e tregtimit dhe përdorimit në kafshë të disa lëndëve me veprim hormonal, tireostatik dhe beta-agonist.

¹¹ Bazuar në urdhri nr. 222, datë 7.4.2015, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi standardet minimale të mbrojtjes së derrave’”, si dhe në urdhrin nr. 651, datë 31.12.2021, “Për miratimin e formateve të protokoll-kontrolleve që kryhen nga veterineri zyrtar”, nëpërmjet protokoll-kontrollit “Për plotësimin e kushteve sanitaro-veterinare dhe mirëqenies së kafshëve në stabilimentet/fermat që mbarështojnë kafshë të gjalla” (shtojca 3).

¹² Sipas rregullores nr. 1, datë 2000, “Mbi sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të kafshëve blegtorale”, urdhrit nr. 459, datë 2.10.2006, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të bagëtitë të imëta’”, dhe urdhrit nr. 407, datë 19.9.2008, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi implementimin e rregullores nr. 1, datë 7.5.2000, në lidhje me matrikujt, pasaportën dhe regjistrin e fermës’”.

- Ajer i përshtatshëm i ventiluar;
- Ndriçim i përshtatshëm, natyral ose artificial;
- Mjetet e pastrimit dhe dezinfektimit që përdoren në stallë, mënyra e funksionimit të tyre;
- Programet e monitorimit;
- Krite të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

c) Mirëqenia e derrave (SMR 10)

Ky kushtëzim¹³ synon mbrojtjen shëndetit dhe mirëqenies së derrave, duke përbushur standardet minimale për kujdesin dhe mbarështimin e tyre. Përveç kërkesave të tjera të mirëqenies së kafshëve të fermës, të gjithë fermerët që mbarështojnë derra duhet të përbushin standardet minimale specifike të mirëqenies përkatëse.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Stafin dhe mbarështimin e duhur të derrave;
- Lirinë e mjaftueshme të lëvizjes;
- Ambientet të përshtatshme për rritjen e derrave;
- Ambientet të përshtatshme të ushqyerjes;
- Ndërprerja e mëmëzimit;
- Dëshmi të prerjes/gjymtimit të rregullt të bishtit;
- Kushtet për higjienë dhe mbarështimin e kafshëve të reja, për riprodhim ose remont krerë/m²;
- Kushtet lidhur me gazrat (amoniak, dyoksid karboni etj.), me ndikim në shëndetin e kafshëve;
- Krite të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

d. Higjiena e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë (SMR 5)

Ky kushtëzim¹⁴ synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të shëndetit publik, si dhe shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

Të gjithë fermerët që prodhojnë ushqim ose ushqim për kafshë nga bimët dhe që rrisin kafshë për ushqim, ose që prodhojnë produkte me origjinë shtazore, duke përfshirë qumështin dhe vezët.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti veterinar nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, për:

- Zbatimin e masave të biosigurisë në fermë, lidhur me vlerësimin e fermës/stabilimentit;
- Ushqimet për kafshët ruhen në mënyrë të sigurt;
- Të dhënat e gjurmueshmërisë të mbahen për të paktën 3 vjet;
- Parazitët në fermë janë nën kontroll të mjaftueshëm;
- Respektimin e periudhave të tërheqjes për produktet e autorizuara;
- Burimet e ushqimit dhe të ujit;
- Dezinfektimet;
- Mjetet e transportit;
- Personelin;
- Vizitorët;
- Magazinimin e ushqimeve;
- Krite të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

¹³ Bazuar në urdhri nr. 222, datë 7.4.2015, "Për miratimin e rregullores 'Mbi standardet minimale të mbrojtjes së derrave'", si dhe urdhrin nr. 651, datë 31.12.2021, "Për miratimin e formateve të protokoll kontrolleve që kryhen nga veterineri zyrtar", nëpërmjet protokoll kontrollit "Plotësimin e kushteve sanitaro-veterinare dhe mirëqenies së kafshëve në stabilimentet/fermat që mbarështojnë derra apo importojnë derra për therje" (shtojca 3).

¹⁴ Bazuar në nenet 23 dhe 25 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar; në udhëzimin nr. 22, datë 25.11.2010, "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor".

ANEKSI 6 KUSHTËZIMET PËR MASËN 5

Pagesa për kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, specat, tranguj), në serra dhe/ose luleshtrydheve në tunele plastike.

Masa e përfitimit është 70 (shtatëdhjetë)% e vlerës totale të faturave tatimore, për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme, por jo më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë për dynym në rastin e dy mbjelljeve në vit.

Për fermerët individualë, që aplikojnë për mbështetje për kontrollin biologjik, sipërfaqja minimale e kultivuar është 1 (një) dynym, ndërsa për aplikantët me status “SHBB” sipërfaqja minimale është 1 (një) ha, për secilën nga mbjelljet.

a) Ndalimi i djegies së mbetjeve bimore në tokat e punueshme, përveç rasteve kur kjo bëhet për arsye të shëndetit të bimëve (GAEC 3)

Ky kushtëzim¹⁵ synon:

Të ndalojë djegien e masës bimore, pjesëve të tyre apo mbetjeve bimore në tokat bujqësore të llojit arë, vresht, pemtore si edhe djegia në kullota, shkurre dhe ferra pa miratimin e autoriteteve, sipas përcaktimeve të VKM-së në fuqi.

Gjatë kontrollit në vend, verifikohet nëse ka prova të djegies së mbetjeve bimore dhe/ose të mbetjeve plastike në tokën bujqësore, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

b) Përdorimi i duhur dhe i sigurt i produkteve për mbrojtjen e bimëve (SMR 7)

Ky kushtëzim synon të:

- sigurojë që aty ku përdoren produkte për mbrojtjen e bimëve, përdorimi i tyre është i nevojshëm dhe që ato përdoren në një mënyrë që minimizon rrezikun për përdoruesin, mjedisin dhe zinxhirin ushqimor; si dhe të sigurojë përputhshmërinë me etiketën e produktit dhe autorizimin e produktit;

- sigurojë që fermerët të përdorin produkte për mbrojtjen e bimëve në mënyrë të sigurt, duke përmbushur kërkesa të caktuara të përdorimit të qëndrueshëm të produkteve të mbrojtjes së bimëve.

Të gjithë përdoruesit profesionistë të produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB) duhet të zbatojnë parimet e përgjithshme të Menaxhimit të Integruar të Dëmtuesve (IPM) dhe të mbajnë të dhëna për të demonstruar zbatimin e Praktikës së Mirë të Mbrojtjes së Bimëve.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti i mbrojtjes së bimëve nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, nëse fermerët disponojnë regjistrin¹⁶ e përdorimit të PMB-ve¹⁷ (produkteve për mbrojtjen e bimëve) të plotësuar me të dhënat e mëposhtme:

- Numri i trajtimeve me PMB-në;
- Arsyeja e përdorimit/dëmtuesi;
- Faza fenologjike e bimës;
- Emri tregtar i PMB-së dhe lënda vepruese;
- Blerë nga: (shoqëruar me faturë);

¹⁵ VKM nr. 404, datë 19.6.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për marrjen e masave parandaluese, për përhapjen e zjarreve në toka bujqësore”, në mbështetje të nenit 16/1, të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar.

¹⁶ Bazuar në VKM-në nr. 317, datë 15.5.2019, “Për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit”, të ndryshuar.

¹⁷ Sipas kërkesave të urdhrat 275, datë 14.6.2022, “Për miratimin e modelit të regjistrit të përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve në fermë, përmbajtjes dhe plotësimit të tij”.

- Sipërfaqja e trajtuar (dynym);
- Doza e përdorur;
- Data e trajtimit;
- Karenca;
- Të dhëna për produktin (data e vjeljes, shitur tek, sasia kg);
- Kriteria të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

ANEKSI 7 KUSHTËZIMET PËR MASËN 8

Pagesa, në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për ha, sipërfaqe të mbjellë me kultura bujqësore. Sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 3 (tre) ha.

Për sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”.

a) Ndalimi i djegies së mbetjeve bimore në tokat e punueshme, përveç rasteve kur kjo bëhet për arsye të shëndetit të bimëve (GAEC 3)

Ky kushtëzim¹⁸ synon:

Të ndalojë djegien e masës bimore, pjesëve të tyre apo mbetjeve bimore në tokat bujqësore të llojit arë, vresht, pemtore si edhe djegia në kullota, shkurre dhe ferra pa miratimin e autoriteteve, sipas përcaktimeve të VKM-së në fuqi.

Gjatë kontrollit në vend, verifikohet nëse ka prova të djegies së mbetjeve bimore dhe/ose të mbetjeve plastike në tokën bujqësore, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

b) Përdorimi i duhur dhe i sigurt i produkteve për mbrojtjen e bimëve (SMR 7)

Ky kushtëzim synon të:

- sigurojë që aty ku përdoren produkte për mbrojtjen e bimëve, përdorimi i tyre është i nevojshëm dhe që ato përdoren në një mënyrë që minimizon rrezikun për përdoruesin, mjedisin dhe zinxhirin ushqimor; si dhe të sigurojë përputhshmërinë me etiketën e produktit dhe autorizimin e produktit;

- sigurojë që fermerët të përdorin produkte për mbrojtjen e bimëve në mënyrë të sigurt, duke përmbushur kërkesa të caktuara të përdorimit të qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëveve.

Të gjithë përdoruesit profesionistë të produkteve për mbrojtjen e bimëve/produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB) duhet të zbatojnë parimet e përgjithshme të Menaxhimit të Integruar të Dëmtuesve (IPM) dhe të mbajnë të dhëna për të demonstruar zbatimin e Praktikës së Mirë të Mbrojtjes së Bimëve.

Gjatë kontrollit në vend, specialisti i mbrojtjes së bimëve nga DRVMB-ja verifikon dhe vlerëson, nëse fermerët disponojnë regjistrin¹⁹ e përdorimit të PMB-ve²⁰ (produkteve për mbrojtjen e bimëve) të plotësuar me të dhënat e mëposhtme:

- Numri i trajtimeve me PMB-në;
- Arsyeja e përdorimit/dëmtuesi;

¹⁸ VKM nr. 404, datë 19.6.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për marrjen e masave parandaluese, për përhapjen e zjarreve në toka bujqësore” në mbështetje të nenit 16/1 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar.

¹⁹ Bazuar në VKM-në nr. 317, datë 15.5.2019, “Për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit”, të ndryshuar

²⁰ Sipas kërkesave të urdhrat 275, datë 14.6.2022, “Për miratimin e modelit të regjistrat të përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve në fermë, përmbajtjes dhe plotësimit të tij”.

- Faza fenologjike e bimës;
- Emri tregtar i PMB-së dhe lënda vepruese;
- Blerë nga: (shoqëruar me faturë);
- Sipërfaqja e trajtuar (dynym;
- Doza e përdorur;
- Data e trajtimit;
- Kategoria,
- Të dhëna për produktin (data e vjeljes, shitur tek, sasia kg);
- Krite të tjera të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

ANEKSI 8

KULTURAT BUJQËSORE/GRUP-KULTURAT PËR MASËN MBËSHTETËSE NR. 8

Grupi	Kodi	Nëngrupi	Specifikime	Sezoni I* (Mbjelljet e para)	
				(1.10.2025–31.5.2026)	
				Mbjellë në vjeshtë 2025	Mbjellje pranverore 2026
Bimë arash	A.1	Pranverore	Misër		x
			Fasule		x
			Luledielli		x
			Sojë		x
			Sorgum		x
	A.2	Të lashta	Grurë	x	
			Tërshërë	x	
			Thekër	x	
			Elb	x	x
		Foragjere njëvjeçare		x	x
		Industriale	Patate		x
			Duham		x
			Panxhar		x
			Pambuk		x
	A.3	Foragjere shumëvjeçare		x	x
		Bimë aromatike-mjekësore		x	x
Dru-frutorë	B.1	Molla		x	x
	B.2	Dru-frutorë, të tjera	Të gjitha llojet e frutave, ulli, agrume dhe vreshta	x	x
	B.3	Arrore	Arra, bajame, lajthi dhe gështenjë (të kultivuara)	x	x

* Sezoni i parë përfshin mbjelljet e kulturave bujqësore në periudhën 1 tetor 2025 deri më 31 maj 2026. Sezoni i dytë përfshin mbjelljet e kulturave bujqësore në periudhën 1 qershor 2026 deri më 30 shtator 2026.

ANEKSI 9

MARRËVESHJE DAKORDËSIE (TIP) I ANËTARËVE TË FAMILJES BUJQËSORE

Sot më datë _____._____.2026, ne, të nënshkruarit, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, si vijon:

1. _____, ID nr. personal _____

Emër Atësi Mbiemër

2. _____, ID nr. personal _____

Emër Atësi Mbiemër

_____, ID nr. personal _____

Emër Atësi Mbiemër

_____, ID nr. personal _____

Emër Atësi Mbiemër

Deklarojmë nën përgjegjësinë tonë personale dhe në njohje të plotë të pasojave që sjell deklarimi i pavërtetë se, përfaqësojmë shumicën e anëtarëve të familjes bujqësore me Kryefamiljar _____ dhe kemi në bashkëpronësi tokë bujqësore, me këto të dhëna:

AMTP në emër të: _____

Nr. i regjistrimit të aktit: _____

Rrethi _____

Fshati _____

Data _____

Ngastra 1: _____

Sipërfaqe m2: _____

Ngastra 2: _____

Sipërfaqe m2: _____

Ngastra __: _____

Sipërfaqe m2: _____

Sa më sipër dhe në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 30.3.2026, “Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2026”, si dhe të udhëzimit përkatës në zbatim të tij, nëpërmjet këtij akti të përbashkët dakordësie, ne, të nënshkruarit:

AUTORIZOJMË

Anëtarin e familjes sonë bujqësore _____ (emër atësi mbiemër), që të kryejë aplikimin në e-Albania për familjen tonë bujqësore dhe të sigurojë çdo dokumentacion të nevojshëm për të përfituar nga masa mbështetëse _____ në lidhje me pasuritë e lartpërmendura. Gjithashtu, në rast miratimi të aplikimit, jemi dakord që të bëhet kalimi i vlerës përkatëse në lekë në llogarinë bankare të tij.

Ne, të nënshkruarit, pranojmë sa më sipër, duke mos pasur asnjë pretendim apo vërejtje për të. Akti, u lexua nga ne me zë të lartë dhe të qartë, u kuptua dhe meqenëse u gjet sipas vullnetit tonë të lirë dhe të plotë, nënshkruhet rregullisht*, si vijon:

Anëtarët e familjes bujqësore:

1.			
Emër	Mbiemër	(me shkrim dore)	Nënshkrimi
Emër	Mbiemër	(me shkrim dore)	Nënshkrimi
Emër	Mbiemër	(me shkrim dore)	Nënshkrimi
Emër	Mbiemër	(me shkrim dore)	Nënshkrimi

* Nënshkrimet (firmat) vendosen në çdo faqe të aktit. Ndërsa në fund të tij vendosen emrat, mbiemrat, nënshkrimet, si dhe bashkëlidhet kopje e mjetit të identifikimit për secilin.

MARRËVESHJE DAKORDËSIE (TIP)
I BASHKËPRONARËVE NË CERTIFIKATËN E PRONËSISË

Sot më datë __. __. 2026, ne, të nënshkruarit, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, si vijon:

1. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër
_____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër
_____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër
_____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

deklarojmë nën përgjegjësinë tonë personale dhe në njohje të plotë të pasojave që sjell deklarimi i pavërtetë se, përfaqësojmë shumicën e bashkëpronarëve dhe kemi në bashkëpronësi tokë bujqësore, me këto të dhëna:

Certifikatë për vërtetim pronësie për bashkëpronarët: _____

Nr. i certifikatës _____

Nr. i zonës kadastrale _____

Numri i pasurisë: _____

Sipërfaqe m2: _____

Certifikatë për vërtetim pronësie për bashkëpronarët: _____

Nr. i certifikatës _____

Nr. i zonës kadastrale _____

Numri i pasurisë: _____

Sipërfaqe m2: _____

Certifikatë për vërtetim pronësie për bashkëpronarët: _____

Nr. i certifikatës _____

Nr. i zonës kadastrale _____

Numri i pasurisë: _____

Sipërfaqe m2: _____

Sa më sipër dhe në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 6.3.2026, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2026”, si dhe të udhëzimit përkatës në zbatim të tij, nëpërmjet këtij akti të përbashkët dakordësie, ne, të nënshkruarit:

AUTORIZOJMË

Bashkëpronarin _____ (emër atësi mbiemër), që të kryejë aplikimin në e-Albania dhe të sigurojë çdo dokumentacion të nevojshëm për të përfituar nga masa mbështetëse _____ në lidhje me pasurinë/të e lartpërmendura. Gjithashtu, në rast miratimi të aplikimit, jemi dakord që të bëhet kalimi i vlerës përkatëse në lekë në llogarinë bankare të tij.

Ne, të nënshkruarit, pranojmë sa më sipër, duke mos pasur asnjë pretendim apo vërejtje për të. Akti, u lexua nga ne, me zë të lartë dhe të qartë, u kuptua dhe meqenëse u gjet sipas vullnetit tonë të lirë dhe të plotë, nënshkruhet rregullisht*, si vijon:

Bashkëpronari/ët:

1. _____
Emër Mbiemër (me shkrim dore) Nënshkrimi

2. _____
Emër Mbiemër (me shkrim dore) Nënshkrimi

Emër Mbiemër (me shkrim dore) Nënshkrimi

* Nënshkrimet (firmat) vendosen në çdo faqe të aktit. Ndërsa në fund të tij vendosen emrat, mbiemrat, nënshkrimet, si dhe bashkëlidhet kopje e mjetit të identifikimit për secilin.

ANEKSI 10 FORMULARËT/RAPORTET E VERIFIKIMIT NË TERREN

Akt verifikimi/kontrolli

Data

Emri Atësia Mbiemri		Numër kontakti i subjektit përfitues	
NIPT		Periudha e aplikimit	
Bashkia			

Parcela	Sip. Parcelës dny m	Mbjellja	Bima 1			Bima 2			Bima 3		
			**Lloji bimës	Sip. Dny m		Lloji bimës	Sip. Dny m		Lloji bimës	Sip. Dny m	
				Deklaruar	Fakt		Deklaruar	Fakt		Deklaruar	Fakt
Parcela 1		Perime serre* Mbjellja I (deri 31 maj 2026)									
		Pemë frutore ekzistuese									
		Kultura në fushë të hapur*** mbjellje të para (vjeshtë pranverë) ose ekzistuese									
		Kulturë e dytë për bimë arash dhe perime									
Parcela 2		Perime serre* Mbjellja I (deri 31 maj 2026)									
		Pemë frutore ekzistuese									
		Kultura në fushë të hapur*** mbjellje të para (vjeshtë pranverë) ose ekzistuese									
		Perime serre* Mbjellja I (deri 31 maj 2026)									
Parcela		Pemë frutore ekzistuese									
		Kultura në fushë të hapur*** mbjellje të para (vjeshtë pranverë) ose ekzistuese									

* Nëse kemi perime, lloji i bimës do lihet bosh dhe do të vendoset vetëm sipërfaqja dny m mbjellje (sezoni I);

** Nëse ka devijime nga bima e deklaruar (mbjellë një bimë tjetër), ajo shtohet në vijim të listës së bimëve, duke vendosur 0 në kolonën e "Deklaruar" dhe sipërfaqja e mbjellë në kolonën "Fakt";

*** Në kultura në fushë të hapur do të konsiderohen bimët e arave, perimet e fushës, foragjeret shumëvjeçare dhe bimët mjekësore-aromatike.

Komente nga subjekti përfitues/përfaqësuesi ligjor:

Komente nga grupi i verifikimit:

Firma e subjektit përfitues

Firma e inspektorit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

ANEKSI 11

FORMULARI I APLIKIMIT PËR INVESTIME 2026

1	Emri/Atësia/Mbiemri	
2	Karta e Idenditetit	
3	Statusi i aplikantit (fermer, Person Fizik, Juridik, SHBB)	
4	SUBJEKTI	
5	NIPT-i/NUIS--i	
6	Adresa e aplikantit / qarku / bashki / fshati	
7	Adresa e investimit/Fermës	
8	Numër kontakti tel/cel	
9	E-mail	

TË DHËNA PËR INVESTIMIN:

INVESTIMI	
PËRSHKRIMI I SHKURTËR (LLOJI)	
VENDNDODHJA E INVESTIMIT (QARKU/BASHKIA/FSHATI)	
SIPËRFAQJA/NR I KRERËVE/ZGJOJE	
SHUMA TOTALE E INVESTIMIT (PA TVSH)	
GRANTI I KËRKUAR	

Nr. i masës	Emërtimi i masës mbështetëse	
10	Për fermerë të rinj, për investime në ferma bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 70 (shtatëdhjetë)%, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.	
11	Për ndërtimin/rikonstruksionin e staneve dhe/ose pajisjeve për përmirësimin e kushteve. Masa e përfitimit të jetë në 70 (shtatëdhjetë)%, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milion) lekë për subjekt.	
12	Për pajisje, makineri dhe mjete bujqësore për mekanizimin dhe modernizimin e processeve të punës në ferma bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 50 (pesëdhjetë)%, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt dhe jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.	

- Unë i nënshkruari _____ pranoj se, kur nga verifikimi rezulton se për masën e aplikuar nuk janë përmbushur kriteret e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në udhëzimin e masës kombëtare 2026, aplikimi skualifikohet.
- Informacioni i gjendur në këtë aplikim është i vërtetë dhe i plotë dhe situata nuk ka ndryshuar që prej datës _____ në dokumentat e dorëzuara.
- Nëse rekomandohet dhënia e grantit, aplikanti do të pranojë kontratën e grantit në të cilën gjenden termat dhe kushtet e përcaktuara për këtë qëllim. Kontrata mund të shkarkohet nga faqja e internetit www.azhbr.gov.al
- Investimet e përfshira në këtë aplikim nuk financohen nga ndonjë donator tjetër vendas, i BE-së ose nga programe të tjera mbështetëse.
- Aplikanti/dhe aksionarët e tij/përfaqësuesit ligjor nuk janë në konflikt interesi me furnitorët, prej të cilëve janë marrë ofertat
- Nëse i jepet granti, aplikanti dhe/ose personi i autorizuar do të bjerë dakord që të vejë në dispozicion, në rastin kur në përputhje me kriteret do kryhet kontrolli pas financimit sipas kontratës, të gjithë ambientet, tokën, ndërtesat, dokumentet dhe çdo informacion tjetër të kërkuar në kuadër të këtij kontrolli, si dhe të ofrojë ndihmën e tij gjatë kryerjes së tij.
- Nëse i jepet granti, aplikanti pranon që të publikohet emri i përfituesit dhe detajet e lidhura me grantin në faqen e internetit të www.azhbr.gov.al.
- Pranoj njoftimet komunikime zyrtare në adresat e sipërpërmendura.

Emër Mbiemër Firmë

Data _____ / _____ / 2026

TË PLOTËSOHET VETËM PËR INVESTIME ME SHPENZIME TË PRANUESHME MBI 1 MILION LEK

Informacion mbi investimin

1- Të jepet informacion i shkurtër mbi aktivitetin aktual të aplikantit, nëse ka.:

- të dhëna mbi fermën bujqësore, blegtorale ose të përzier;
- pronën dhe sipërfaqet bujqësore;
- kulturat që kultivohen sipas sezoneve dhe sasi të përkatëse të prodhimit;
- për fermat blegtorale, numrin e krerëve sipas Regjistrit Elektronik të Blegtorisë (RUDA);
- eksperiencën e deritanishme në aktivitetin bujqësor/blegtoral.

2- Potenciali i tregut dhe Plani i Marketingut për produktin që prodhoni ose që do të prodhohet

a) Identifikimi i tregut ku do të shitet produkti (treg lokal, rajonal ose kombëtar), si dhe karakteristikat kryesore të konsumatorëve të synuar.

b) Niveli aktual i kërkesës për produktin dhe vlerësimi i pritshëm i zhvillimit të saj gjatë periudhës së afatmesme.

d) Pozicionimi i produktit në treg, duke sqaruar avantazhet konkurruese, cilësinë dhe veçoritë dalluese.

e) Kanalet e marketingut dhe shpërndarjes që do të përdoren (p.sh. tregjet lokale, pika grumbullimi, kontrata furnizimi, shitje direkte).

3- Të përshkruhet investimi i synuar (detaje mbi zërat e investimit, procesin e prodhimit, kostot dhe të ardhurat e pritshme):

- **Zërat e investimit**, duke detajuar pajisjet, ndërtimet, makineritë, teknologjitë ose shërbimet që do të financohen.
- **Procesi i prodhimit**, përfshirë mënyrën e organizimit të aktivitetit, kapacitetin prodhues dhe ndryshimet që sjell investimi krahasuar me situatën aktuale.
- **Kostot e investimit**, duke përfshirë kostot e realizimit dhe funksionimit, sipas dokumentacionit financiar shoqërues.
- **Të ardhurat e pritshme**, duke përshkruar ndikimin e investimit në rritjen e prodhimit, shitjeve dhe qëndrueshmërisë ekonomike të aktivitetit.

ANEKSI 12

MARRËVESHJE DAKORDËSIE (TIP) I ANËTARËVE TË FAMILJES BUJQËSORE

Sot më datë _____, 2026, ne, të nënshkruarit, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, si vijon:

1. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

2. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

3. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

4. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

deklarojmë nën përgjegjësinë tonë personale dhe në njohje të plotë të pasojave që sjell deklarimi i pavërtetë se, përfaqësojmë anëtarët aktualë të familjes bujqësore me Kryefamiljar _____ dhe kemi në bashkëpronësi tokë bujqësore, me këto të dhëna:

AMTP në emër të: _____
Nr. i regjistrimit të aktit: _____
Rrethi _____
Fshati _____
Data _____

Ngastra 1.....
Sipërfaqe m2:
.....
Ngastra 2:
Sipërfaqe m2:
.....
Ngastra3.....
Sipërfaqe m2:
.....
Ngastra4
Sipërfaqe m2:

Sa më sipër dhe në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 30.3.2026 "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2026", si dhe të udhëzimit përkatës në zbatim të të tij, nëpërmjet këtij akti të përbashkët dakordësie, ne, të nënshkruarit:

AUTORIZOJMË

Anëtarin e familjes sonë bujqësore _____ (emër atësi mbiemër), që të kryejë aplikimin për investimin (Investimi sipas masës) _____ dhe të sigurojë çdo dokumentacion të nevojshëm për të përfituar nga masat e investimeve 2026, në lidhje me pasuritë e lartpërmendura. Kjo marrëveshje bëhet për një afat (jo më pak se 5 vjet). Gjithashtu, në rast miratimi të aplikimit, jemi dakord që të bëhet kalimi i vlerës përkatëse në lekë në llogarinë bankare të tij.

Ne, të nënshkruarit, pranojmë sa më sipër, duke mos pasur asnjë pretendim apo vërejtje për të. Akti, u lexua nga ne me zë të lartë dhe të qartë, u kuptua dhe meqenëse u gjet sipas vullnetit tonë të lirë dhe të plotë, nënshkruhet rregullisht*, si vijon:
Anëtarët e familjes bujqësore:

1. _____	_____
Emër Mbiemër (me shkrim dore)	Nënshkrimi
2. _____	_____
Emër Mbiemër (me shkrim dore)	Nënshkrimi
3. _____	_____
Emër Mbiemër (me shkrim dore)	Nënshkrimi
4. _____	_____
Emër Mbiemër (me shkrim dore)	Nënshkrimi

* Nënshkrimet (firmat) vendosen në çdo faqe të aktit. Ndërsa në fund të tij vendosen emrat, mbiemrat dhe nënshkrimet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

ANEKSI 13

FORMULARI I KERKESES PER PAGESE 2026

1	EMRI/ATESIA/MBIEMRI ¹	
2	KARTA IDENTITETIT	
3	STATUSI I APLIKANTIT	
4	SUBJEKTI	
5	NIPT – i	
6	QARKU/RRETHI /BASHK/FSHATI	
7	NUMER KONTAKTI TEL/CEL	
8	VENDNDODHJA E INVESTIMIT	
9	EMRI I BANKËS	
10	LLOGARIA BANKARE NË LEK	
11	IBAN	

MASA 10 E MBËSHTETJES:

Për fermerë të rinj, për investime në ferma bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 70 (shtatëdhjetë)%, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

¹ Emri/Atesia/Mbiemri – të shënohen me gërma kapitale

Shënim: Ju lutemi përdorni këtë listë për të kontrolluar dokumentat që ju do të paraqisni në varësi të masës.

- Formularin e kërkesës për pagesë sipas Aneksit 13;
- Regjistrin e plotësuar/ përditësuar të fermës;
- Faturë/faturat tatimore, shoqëruar me specifikimet teknike të elementeve përkatës dhe vlerën e elementëve përbërës sipas kontratës;
- Situacionin e punimeve të kryera (për ndërtim);
- Akt zhdoganimit për mallrat/pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementëve përbërës;
- Transaksionin bankar, dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë

Shënim: Ju lutemi të paraqisni listën e të gjitha faturave dhe të llogarisni totalin e parashikuar të shumës së shpenzimeve të pranueshme.

Nr	Përshkrimi i shpenzimit	Emri furnitorit	Nr. Faturës	Data faturës	Sasia	Shuma në Lek pa TVSH

Vlera e shumës së kërkuar për pagesë: _____ Lek

(_____)

70% e vlerës së shumës totale të shpenzimeve të pranueshme.

Emri i përfituesit

Nënshkrimi

Data



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

ANEKSI 14

PROJEKT IDE - NDËRTIMI / RIKONSTRUKSIONI I STANEVE (MASA 11)

A) Të dhëna të përgjithshme të aplikantit

1. Emri / Mbiemri / Subjekti: _____
2. Statusi juridik:
☐ Fermer individual ☐ Person fizik ☐ Person juridik ☐ SHBB
3. NIPT / NUIS: _____
4. Vendndodhja investimit (Qark - Bashki - Njësi administrative - Fshat):

5. Emërtimi i vendndodhjes së stanit: _____
6. Distanca nga vendqendrimi midis fermës blegtorale dhe kullotës _____ km
7. Numër kontakti: _____
8. Email: _____

B) Të dhëna mbi aktivitetin blegtoral

1. Aktiviteti kryesor:
☐ Blegtori ☐ Bujqësi ☐ Fermë mikse
2. Lloji i blegtorisë:
☐ Të imta (dele/dhi); ☐ Gjedh; ☐ Mikse
3. Numri aktual i krerëve (sipas sistemit RUDA): _____
4. Përvoja në aktivitet (vite): _____
5. Përdorimi i stanit:
☐ Sezonal (verim/kullota) ☐ Sezonal (dimërim/kullota) ☐ Gjatë gjithë vitit
6. Distanca nga vendbanimi i përhershëm: _____ km

C) Përshkrimi i projektit

1. Titulli i projektit: Ndërtimi / Rikonstruksioni i një stani blegtoral në kullota

2. Përshkrimi i projektit (i detajuar):

Projekti synon ndërtimin ose rikonstruksionin e një stani blegtoral si njësi funksionale sezonale në kullota, i cili shërben për:

- strehimin e përkohshëm të tufës gjatë periudhës së kullotjes;
- mbrojtjen e bagëtive nga kushtet atmosferike dhe nga kafshët grabitqare;
- sigurimin e kushteve bazë për menaxhimin e aktivitetit blegtoral në terren;
- garantimin e kushteve minimale të jetesës dhe punës për barinjtë;
- ruajtjen dhe administrimin e produkteve blegtorale dhe inputeve ushqimore.

D) Ndikimi i pritshëm i investimit

Investimi pritët të kontribuojë në:

1. Përmirësimin e kushteve të mbarështimit dhe mirëqenies së bagëtive, në përputhje me praktikatat e mira blegtorale;
2. Rritjen e sigurisë së tufës përmes masave mbrojtëse ndaj grabitqarëve dhe faktorëve natyrorë;
3. Shfrytëzimin më efikas dhe të qëndrueshëm të kullotave natyrore;
4. Përmirësimin e organizimit të aktivitetit blegtoral në kushte terreni;
5. Sigurimin e kushteve bazë të jetesës dhe punës për barinjtë;
6. Reduktimin e humbjeve në prodhim dhe rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të aktivitetit.

E) Të dhëna teknike të investimit

A. Infrastruktura për bagëtitë (prioritare)

1. Ndërtim / rikonstruksion vathe:
 - Sipërfaqe: _____ m²
 - Materiali: ☐ Dru ☐ Gur ☐ Metal ☐ Tjetër _____
2. Kapaciteti i planifikuar (nr. krerësh): _____
3. Rrethim mbrojtës:
☐ Po ☐ Jo
4. Masa për mbrojtje nga grabitqarët të planifikuar për sigurinë e tufës:
 - ☐ Rrethim i përfortuar i vathës
 - ☐ Gardh metalik / rrjetë mbrojtëse
 - ☐ Gardh elektrik (kur është i aplikueshëm)
 - ☐ Mbyllje e sigurt e tufës gjatë natës
 - ☐ Ndriçim i jashtëm / ndriçim me sensor
 - ☐ Përdorimi i qenve roje
 - ☐ Sistem sinjalizimi / alarmi
 - ☐ Ndarje e veçantë për kategoritë e rrezikuara (qengja/keca)
 - ☐ Prani e vazhdueshme e bariut / roje sezonale
 - ☐ Të tjera: _____
- 4.1. Përshkrim i detajuar i masave të parashikuara (opsionale):

B. Infrastruktura funksionale

1. Ambient teknik (ruajtje qumështi, ushqim, materiale):
 - Sipërfaqe: _____ m²
2. Burimi i ujit:
☐ Natyror ☐ Depozitë ☐ Tjetër _____
3. Furnizimi me energji:
 - ☐ Panele fotovoltaike (fuqia _____ kW)
 - ☐ Gjenerator
 - ☐ Tjetër _____
4. Hapësira për përpunim fillestar (nëse aplikohet):
☐ Po ☐ Jo
Përshkrimi: _____

C. Ambienti për barinjtë

1. Sipërfaqe totale (deri në 50 m²): _____ m²
2. Ndarja funksionale:
 - Ambient ndenjeje: _____ m²
 - Ambient fjetjeje: _____ m²
 - Ambient sanitar: _____ m²
3. Materiali ndërtimor:
 - ☐ Dru ☐ Gur ☐ Metal + panel ☐ Tjetër _____

D. Të dhëna shitesë

1. Akses rrugor:
 - ☐ Po ☐ Jo
2. Pronësia e tokës/kullotës:
 - ☐ Pronësi ☐ Qira (minimumi 3 vite)
3. Sipërfaqja totale e investimit: _____ m²

Të dhëna mbi kullotën dhe kapacitetin mbajtës

1. Statusi i përdorimit të kullotës:
 - ☐ Pronësi ☐ Qira (minimumi 3 vite) ☐ Përdorim me autorizim nga autoriteti përgjegjës
 - ☐ Tjetër: _____
2. Periudha e përdorimit të kullotës:
 - Nga ____ / ____ / ____ deri më ____ / ____ / ____
3. Burimi i ujit për bagëtitë në kullotë:
 - ☐ Natyror (burim, përrua, liqen)
 - ☐ Depozitë ☐ Rezervuar ☐ Lerë
 - ☐ Transport uji
 - ☐ Tjetër: _____

F) Të dhëna financiare

1. Vlera totale e investimit (pa TVSH): _____ Lekë
2. Granti i kërkuar (deri në 70%): _____ Lekë
3. Kontributi i aplikantit: _____ Lekë
4. Struktura e investimit:
 - Infrastrukturë blegtorale: _____ %
 - Infrastrukturë funksionale: _____ %
 - Ambient banimi: _____ %

G) Deklaratë

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe të sakta dhe se investimi do të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Emri / Mbiemri: _____ Firma: _____ Data: ____ / ____ / 2026

***Shënim:** Ky formular përdoret për vlerësimin e projekteve që lidhen me ndërtimin dhe rikonstruksionin e staneve si struktura funksionale blegtorale në kullota, në mbështetje të sistemeve tradicionale dhe moderne të mbarështimit ekstensiv.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

ANEKSI 15

FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË 2026

1	EMRI/ATËSIA/MBIEMRI ¹	
2	KARTA IDENTITETIT	
3	STATUSI I APLIKANTIT	
4	SUBJEKTI	
5	NIPT – i	
6	QARKU/RRETHI /BASHKIA/FSHATI	
7	NUMËR KONTAKTI TEL/CEL	
8	VENDNDODHJA E INVESTIMIT	
9	EMRI I BANKËS	
10	LLOGARIA BANKARE NË LEK	
11	IBAN	

MASA 11 E MBËSHTETJES:

Për ndërtimin/rikonstrukcionin e staneve dhe/ose pajisjeve për përmirësimin e kushteve. Masa e përfitimit të jetë në 70 (shtatëdhjetë)%, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milion) lekë për subjekt.

¹ Emri/Atesia/Mbiemri – të shënohen me gërma kapitale

Shënim: Ju lutemi përdorni këtë listë për të kontrolluar dokumentat që ju do të paraqisni në varësi të masës.

- a. Formularin e kërkesës për pagesë sipas Aneksit 15.
- b. Regjistrin e plotësuar/ përditësuar të fermës;
- c. Faturë/faturat tatimore, shoqëruar me specifikimet teknike të elementeve përkatës dhe vlerën e elementëve përbërës sipas kontratës;
- d. Situacionin e punimeve të kryera (për ndërtim);
- e. Akt zhdoganimit për mallrat/pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementëve përbërës;
- f. Transaksionin bankar, dhe/ose SWIFT-in (për pagesat ndërkombëtare) për të gjitha pagesat, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi;
- g. Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- h. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

Shënim: Ju lutemi të paraqisni listën e të gjitha faturave dhe të llogarisni totalin e parashikuar të shumës së shpenzimeve të pranueshme.

Nr	Përshkrimi i shpenzimit	Emri furnitorit	Nr. Faturës	Data faturës	Sasia	Shuma në Lek pa TVSH

Vlera e shumës së kërkuar për pagesë: _____ Lek

(_____)

70% e vlerës së shumës totale të shpenzimeve të pranueshme.

Emri i përfituesit

Nënshkrimi

Data



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

ANEKSI 16

FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË 2026

1	EMRI/ATËSIA/MBIEMRI ¹	
2	KARTA IDENTITETIT	
3	STATUSI I APLIKANTIT	
4	SUBJEKTI	
5	NIPT – i	
6	QARKU/RRETHI /BASHKIA/FSHATI	
7	NUMËR KONTAKTI TEL/CEL	
8	VENDNDODHJA E INVESTIMIT	
9	EMRI I BANKËS	
10	LLOGARIA BANKARE NË LEK	
11	IBAN	

MASA 12 E MBËSHTETJES:

Për pajisje, makineri dhe mjete bujqësore për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në ferma bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 50 (pesëdhjetë)%, të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt dhe jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.

¹ Emri/Atesia/Mbiemri – të shënohen me gërma kapitale